



Kongresi i V i KASH
Rrapaj: 25 vite kontribut.
Bujqësia në prag të
reformave, kërkesa
urgjente për mbështetje

Faqe 2



Kongresi i V i KASH
miraton Rezolutën
Kombëtare për Agrobi-
znesin: Kërkesë për masa
urgjente në financim,
legjislacion dhe kooperim

Faqe 2



Thellohet partneriteti
Shqipëri-Gjermani,
fokusi tek bujqësia
moderne dhe
zhvillimi rural

Faqe 10



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit nëntor 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 521
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH) KONFERENCA E TRETË E GQSP-UNIDO DHE KONGRESI I V I KASH: FOKUS TE CILËSIA, SIGURIA USHQIMORE DHE STANDARDET

Shqipëria po ndërmerr hapa të rëndësishëm për forcimin e konkurrueshmërisë së agrobizneseve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për t'u integruar në tregun europian dhe atë global. Objektivi strategjik për të arritur 1 miliardë euro eksporte deri në vitin 2030 ishte në fokus të Forumit të 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet, organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), në bashkëpunim me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH)

ALBANIA

**Programi Global
Për Cilësi dhe
Standarde**

UNIDO
UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



**BE-ja dhe Suedia
mbështesin sipërmarrjen
dhe inovacionin
në Shqipëri përmes
EU4Innovation**



Faqe 10

STARTUP-ET

**Sipërmarrja e gjelbër:
Bio-Waste Innovation
Challenge prezanton
11 ide innovative për
trajtimin e mbetjeve bio**

Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT



**Hapat që ndiqen për kalimin e fermës, nga fermë
e zakonshme në fermë biologjike**

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 11

TEMA TË DITËS

- Salla: Gjurmueshmëria është "pasaporta europiane" e produkteve shqiptare Fq.4
- Roli i Zvicrës dhe UNIDO: Cilësia është çelësi i besimit Fq.4
- Master i ri për cilësinë në Universitetin Bujqësor Fq.4
- KASH: Bashkëpunim publik-privat për Shqipërinë në BE në 2030 Fq.4
- Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban - Prof. As. Dr. Eqrem & Ema Meçollari Fq.13

BIMË MJEKËSORE

**Nga Fusha në Magazinë
- Si të Ruajmë Cilësinë
e Bimëve Aromatike
dhe Mjekësore**



Faqe 7

Kongresi i V i KASH - Rrapaj: 25 vite kontribut. Bujqësia në prag të reformave, kërkesa urgjente për mbështetje

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) zhvilloi Kongresin e V, duke shënuar 25 vjet veprimtari në përfaqësimin e fermerëve dhe agrobiznesit. Kryetari Agim Rrapaj theksoi se sektori bujqësor ndodhet në një moment vendimtar, ndërsa Shqipëria po afron hapjen e kapitullit të fundit të negociatave me BE-në, që përfshin edhe bujqësinë.

Gjatë punimeve u prezantua raporti i dekadës 2015–2025

dhe u miratua një rezolutë me katër kërkesa kryesore ndaj qeverisë:

- Mbështetje urgjente financiare e fiskale: falja e gjobave për 104 SHBB dhe zgjerim i mbështetjes për prodhimin.

- Paketë ligjore prioritare: ndryshime në ligjet për kooperimin, TVSH-në, akcizat dhe zhvillimin rural, si dhe një ligj i ri për sigurimin bujqësor.

- Nxitja e IPARD III: nisja e disbursimit të fondeve brenda

gjysmës së parë të vitit 2026.

- Reforma në struktura dhe modernizim: krijimi i një njësie të posaçme për kooperimin në MBZHR dhe ngritja e Regjistrat Kombëtar të Mekanikës Bujqësore.

Kongresi vuri theksin te nevoja për më shumë koordinim, investime dhe digjitalizim, me synimin që masat të sjellin rezultate të prekshme për fermerët dhe agropërpunuesit në vitet 2026–2030.

RAPORT PËR KONGRESIN E V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

- Fjala e plotë e Kryetarit të KASH, Agim Rrapaj -

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, përfaqësues të shoqatave të prodhuesve, përpunuesve e eksportuesve, përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerë ndërkombëtarë dhe miq të agrobiznesit shqiptar,

për fermerët dhe agropërpunuesit.

Kongreset I–IV (2001–2015) ndërtuan arkitekturën e përfaqësimit, sollën karburantin pa akcizë për fermerët, forcuan lidhjet me partnerët ndërkombëtarë dhe përcaktuan katër shtyllat strategjike të KASH, që mbeten busull edhe sot. Shqipëria është në përfundim të hapjes së kapitujve të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Kapitulli fundit ku pëfshihet edhe bujqësia do të hapet në datën 19 nëntor mbas 8 ditësh. Ky proces kërkon përafrim të legjislacionit, forcim të organizimit të prodhuesve, transparencë financiare dhe mbrojtje reale të fermerëve. Në këtë kontekst, roli i KASH bëhet edhe më i domosdoshëm.

Sot ne prezantojmë Raportin e Kongresit të V, që përmbledh një dekadë pune, sfida, suksese dhe propozime konkrete që KASH ka paraqitur para qeverisë dhe institucioneve.

PËRMBLEDHJE E KONGRESEVE TË MËPARSHME (2001-2015)

KASH ka mbajtur katër kongrese, të cilat kanë shërbyer si forume kyçe për analizën dhe miratimin e strategjive sektoriale.

Kongresi I, i mbajtur më 10 Maj 2001, në prani të 400 përfaqësuesve, konsolidoi themelet demokratike dhe Këshillat Rajonale, duke rritur besimin për të ardhmen e veprimtarisë së KASH.

Kongresi II, i mbajtur më 2 Maj 2005, me pjesëmarrje të gjerë (mbi 2000 përfaqësues), vlerësoi suksesin e projekteve si “Karburanti pa Akcizë”. Megjithatë, zbatimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 16.11.2005, për këtë nismë, u ndërpre pas ndryshimeve politike të vitit 2005, largimit të donatorëve dhe mungesës së kapaciteteve në administratën e re.

Kongresi III, i mbajtur më 10 Qershor 2010, konsolidoi marrëdhëniet me Kosovën dhe organizatat ndërkombëtare. Në këtë periudhë u vu re një dëmtim i rolit të KASH si përfaqësues i sektorit privat, si pasojë e

(Vijon në faqen 5)

Kongresi i V i KASH miraton Rezolutën Kombëtare për Agrobiznesin: Kërkesë për masa urgjente në financim, legjislacion dhe kooperim

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) ka miratuar Rezolutën Kombëtare për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe agroushqimor, në përfundim të punimeve të Kongresit të tij të pestë. Dokumenti strategjik, i bazuar në katër shtylla kryesore – kooperimi, mekanizimi, financimi dhe përafrimi ligjor me BE-në, përcakton masat që kërkojnë veprim të menjëhershëm nga qeveria dhe institucionet përgjegjëse.

KASH evidentoi se fragmentarizimi i tokës dhe mosfunksionimi i Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) mbeten ndër pengesat kryesore të sektorit, duke kërkuar faljen e gjobave për 104 SHBB-të dhe ngritjen e një strukture të posaçme për kooperimin në MBZHR. Po ashtu, u theksua nevoja për krijimin e një Regjistrit Kombëtar të Subjekteve të Agrobiznesit dhe pro-

grame të certifikuara trajnimi për drejtuesit e kooperativave.

Në fushën e mekanizimit, KASH kërkon miratimin urgjent të Librit Kombëtar të Mekanikës Bujqësore, futjen e mjeteve bujqësore në sistemin e qarkullimit rrugor dhe rishikimin e akcizës për karburantin bujqësor, ndërsa vlerësoi skemën 50% të subvencionimit si hap pozitiv, por të pamjaftueshëm.

Sa i takon financimin, KASH bëri thirrje për nisjen e disbursimeve të IPARD III brenda 6-mujorit të parë të vitit 2026, dyfishimin e Skemës Kombëtare të Mbështetjes dhe përfshirjen e institucioneve të mikrofinancës në garancinë sovranë dhe instrumentet e Bankës së Shqipërisë.

Në pjesën ligjore, Rezoluta kërkon trajtim urgjent nga Kuvendi të paketës së ndryshimeve për ligjet e kooperimit, TVSH-së, akcizave, zhvillimit

rural dhe sigurimit të prodhimit bujqësor, ku ligji i ri për sigurimet synohet të miratohet brenda vitit 2026.

Kongresi përcaktoi edhe indikatorë konkretë monitorimi për vitin 2026, përfshirë rritjen e mekanizimit, funksionalizimin e kooperimit dhe përshejtimin e disbursimeve të fondeve europiane.

Në bilancin e 25 viteve të veprimtarisë, KASH theksoi se ka ndërtuar një rrjet prej 37 shoqatash dhe këshillash rajonalë, ka zhvilluar mbi 200 trajnime dhe dhjetëra tryeza sektoriale, duke ndikuar në politikat që prekin mbi 100 mijë fermerë e agropërpunues në vend.

Rezoluta pritet t'i paraqitet zyrtarisht institucioneve shtetërore, me kërkesën për kalendar zbatimi dhe angazhim institucional për periudhën 2026–2030.

REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

Tiranë, 11 Nëntor 2025

QËLLIMI DHE KONTEKSTI I REZOLUTËS

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në përfundim të punimeve të Kongresit të V-të, miraton këtë Rezolutë Kombëtare për Agrobiznesin Shqiptar, me qëllim përcaktimin e prioritetëve strategjike dhe masave që kërkojnë bashkërendim të menjëhershëm mes qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve të zhvillimit.

Rezoluta bazohet në katër shtyllat themelore të zhvillimit të sektorit:

Kooperimi dhe Koordinimi, Mekanizimi dhe Inovacioni, Financimi dhe Disbursimi i Fondeve Grant, Legjislacioni dhe Përafrimi me BE-në.

Këto përbëjnë boshtin kryesor mbi të cilin KASH ndërton kontributin e tij në zhvillimin rural dhe agroushqimor të vendit.

I. PROCESI I KOOPERIMIT DHE KOORDINIMIT

Sfidat aktuale

Fragmentarizimi i tokës (1.8 milionë parcela nga Ligji nr. 7501/1991) dhe mosfunksionimi efektiv i Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) kanë dëmtuar ndjeshëm procesin e bashkëpunimit.

Ligji nr. 38/2012 “Për SHBB” ka rezultuar i paefektshëm për shkak të mungesës së një strukture të posaçme në MBZHR, konkurrencës së pandershme dhe barrës së lartë fiskale. 104 SHBB-të e krijuara janë penalizuar me gjoka nga administrata tatimore, pa marrë parasysh fazën e konsolidimit.

Propozimet e KASH

- Ngritja e një Drejtorie të Veçantë për Kooperimin në strukturën e MBZHR-së.
- Falja e menjëhershme e gjobave dhe kamatëvonesave për 104 SHBB-të, si masë

besimi për rimëkëmbjen e kooperimit.

3. Krijimi i një Regjistri të Ri Kombëtar të Subjekteve të Agrobiznesit në bashkëpunim me QKB.

4. Hartimi i kurrikulave të posaçme për trajnimin e drejtuesve të SHBB-ve dhe Grupimeve Vendore të Veprimit (GVV), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit.

Masat e Qeverisë (Status 2025)

- MBZHR dhe FAO kanë nisur rishikimin e Ligjit 38/2012, në proces konsultimi publik.

- Nuk ka akt për amnisti fiskale për SHBB-të.

- Sistemi i ri i regjistrimit të fermerëve dhe grupeve ekonomike është në diskutim teknik për integrim në QKB.

- Qeveria ka shpallur paketën “Zhvillimi i Maleve” që përfshin stimuj fiskalë për bashkëpunim në zonat e vështira.

II. MEKANIZIMI, INOVACIONI DHE DIGJITALIZIMI

Sfidat aktuale

Sektori i bujqësisë vuan nga mungesa e mekanizimit modern dhe parku i amortizuar i mjeteve (mbi 25 vjet përdorim).

Shqipëria ka vetëm 1.24 traktorë për 100 ha, kundrejt mesatares së BE-së prej 8.1 traktorë.

Mungesa e regjistrit kombëtar dhe pamundësia për përdorimin e mjeteve si kolateral e thellojnë informalitetin dhe koston e prodhimit.

Propozimet e KASH

1. Krijimi i Librit Kombëtar të Mekanikës Bujqësore, si bazë për regjistrim, kolateral dhe sigurim.

2. Pajisja e drejtuesve të mjeteve

(Vijon në faqen 4)

REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

KONFERENCA E TRETË E GQSP-UNIDO DHE KONGRESI I V I KASH: FOKUS TE CILËSIA, SIGURIA USHQIMORE DHE STANDARDET

Shqipëria drejt rritjes së konkurrueshmërisë: Forumi i 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet vendos bazat për eksportet drejt BE-se

Shqipëria po ndërmerr hapa të rëndësishëm për forcimin e konkurrueshmërisë së agrobizneseve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për t’u integruar në tregun europian dhe atë global. Objektivi strategjik për të arritur 1 miliardë euro eksporte deri në vitin 2030

Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Në Forumin e 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet, zhvilluar paralelisht me Kongresin e 5-të të KASH-it, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) nënvizoi rolin në rritje të UBT-së në formësimin



e agjendës kombëtare për cilësi-në, standardet dhe zhvillimin rural. Ai theksoi se UBT po shndërrohet në një qendër kombëtare ku bashkohen ekspertiza akademike, politikat publike dhe nevojat e sektorit privat, për të udhëhequr transformimin e bujqësisë dhe agropërpunimit në përputhje me kërkesat europiane.

Ai vuri në dukje se, përmes bashkëpunimit afatgjatë me Ministrinë e Bujqësisë, UNIDO-n, KASH-in dhe partnerë të tjerë,

UBT është kthyer në një pikë referimi për zhvillimin rural, përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe integrimin e prodhuesve shqiptarë në tregjet rajonale dhe të BE-së. “Cilësia dhe standardet, theksoi ai, nuk janë më lista teknike kontrolli, por një kuadër modern zhvillimi dhe “karta e identitetit” e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare.Pa përputhje me standardet e njohura, produktet shqiptare nuk mund të sigurojnë praninë e qëndrueshme në tregjet europiane”.

Në këtë kuadër, Rektori evidentoi kontributin strategjik të UNIDO-s në forcimin e infrastrukturës kombëtare të cilësisë dhe kapaciteteve të ndërmarrjeve, ndërsa UBT-ja luan rolin e partnerit akademik përmes formimit të profesionistëve dhe integritit të praktikave më të mira ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim. Ai njoftoi se, në bashkëpunim të ngushtë me UNIDO-n dhe në kornizë të përbashkët akademike me Universitetin BOKU të Vjenës, UBT po finalizon programin e ri të Masterit në “Sistemet e Cilësisë dhe Standardet”, i cili synon të formojë një brez të ri specialistësh në cilësi, pajtueshmëri dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në mbyllje, ai ripohoi angazhimin e UBT-së për të vepruar si laborator kombëtar i dijes dhe inovacionit dhe si partner i besueshëm në të gjitha iniciativat që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe forcimin e standardeve në funksion të një ekonomie bujqësore konkurruese dhe të qëndrueshme.

Dr. Elvana Zhezha, Koordinatore Kombëtare e UNIDO & GQSP në Shqipëri

Dr. Elvana Zhezha, Koordinatore Kombëtare e UNIDO-s dhe e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) në Shqipëri, theksoi se cilësia dhe standardet janë bazë e konkurrueshmërisë

së ndërmarrjeve dhe parakusht kyç për integrimin e Shqipërisë në tregjet europiane. Ajo nënvizoi se GQSP po mbështet ndërtimin e një sistemi funksional të cilësisë në vend, duke forcuar laboratorët, institucionet teknike dhe kapacitetet e prodhuesve, me synim përafrimin me kërkesat e BE-së dhe rritjen e besueshmërisë së produkteve shqiptare.

Dr. Zhezha vuri në dukje bashkëpunimin e ngushtë me UBT-në, të cilin e konsideroi element strategjik për ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme të dijes dhe formimin e profesionistëve të rinj në fushën e cilësisë. Ajo përshëndeti partneritetin UNIDO-UBT në zhvillimin e programit të ri të Masterit në “Standards and Quality Systems”, si një investim afatgjatë për krijimin e ekspertizës vendase dhe për forcimin e sistemeve publike dhe private të cilësisë.

Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë e punës me bizneset, shoqatat dhe aktorët lokalë për të përmirësuar praktikën e sigurisë ushqimore, gjurmueshmërisë dhe dokumentimit, si dhe rolin e instrumenteve të inovacionit, përfshirë digjitalizimin dhe qasjet moderne të kontrollit të cilësisë. Përmes këtyre ndërhyrjeve, GQSP synon të krijojë një mjedis ku ndërmarrjet shqiptare operojnë mbi baza të qarta standardesh dhe prodhojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe transparente.

Në përmbyllje, Dr. Zhezha konfirmoi angazhimin e UNIDO-s për të mbështetur Shqipërinë në forcimin e infrastrukturës kombëtare të cilësisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve, duke e konsideruar bashkëpunimin me institucionet vendase, veçanërisht UBT-në, si thelbësor për arritjen e rezultateve të qëndrueshme dhe për vendosjen e cilësisë si një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik të vendit.

Sh.S. Znj. Ruth Huber, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri

Sh.S. znj. Ruth Huber, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri, theksoi se Forumi po zhvillohet në një moment vendimtar për procesin e integritit europian të Shqipërisë, ku “cilësia dhe standardet” janë në thelb të klasterit të Tregut të Brendshëm dhe lëvizjes së lirë të mallrave. Ajo nënvizoi se këto kapituj nuk përbëjnë vetëm detyrime teknike. Ato formojnë themelin e besimit midis prodhuesve shqiptarë dhe konsumatorëve europianë dhe kërkojnë përafrim të plotë të legjislacionit dhe

ishite në fokus të Forumit të 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet, organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), në bashkëpunim me Këshillin e Agrobiznesit Shqiptar (KASH).

infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri me acquis të BE-së për akreditimin, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut. Ajo shtoi se standardet e cilësisë nuk janë vetëm një kërkesë e BE-së, por edhe një domosdoshmëri për qytetarët dhe bizneset shqiptare, pasi ndihmojnë në rritjen e besimit të konsumatorit dhe forcimin e prodhuesve vendas në të gjitha sektorët.

Ambasadorja Huber vuri në dukje partneritetin afatgjatë të Zvicrës me Shqipërinë dhe rolin e bashkëpunimit ekonomik zviceran, veçanërisht përmes mbështetjes së SECO-s për Programin Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP). Kjo mbështetje kontribuon në ndërtimin e një infrastrukture kombëtare cilësie të qëndrueshme, në pajisjen e agrobizneseve me teknologji moderne dhe në mundësimin e eksporteve të qëndrueshme dhe mbrojtjes më të mirë të konsumatorëve shqiptarë. Ajo theksoi se qëndrueshmëria dhe përfshirja janë në qendër të këtij partneriteti, me fokus në ofrimin e mundësive dhe mjeteve të nevojshme për prodhuesit ruralë, gratë dhe të rinjtë që të konkurrojnë me sukses. Në këtë kontekst, ajo përshëndeti iniciativa si “Programi i ri Ndërkombëtar i Masterit në Cilësi dhe Standarde”, i zhvilluar me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe i promovuar edhe në vende të tjera të GQSP-së, si një investim kyç në ekspertizën e së ardhmes dhe në forcimin e markës “Made in Albania” si sinonim i cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë.



Forum i 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë konferencës së tretë të programit GQSP – UNIDO, theksoi se prioriteti kryesor kombëtar mbetet integrimi i Shqipërisë në BE. Ai u ndal veçanërisht tek rëndësia e kapitujve 11 dhe 12 të negociatave, të cilët lidhen drejtpërdrejt me sektorin agro-ushqimor dhe modernizimin e tij.

- Fjala e plotë e ministrit të Bujqësisë Andis Salla -

Të nderuar të ftuar, partnerë dhe miq,

Më lejoni ta nis këtë fjalë me objektivin tonë më të rëndësishëm kombëtar që është integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian.



konsumatorin evropian, është pasaporta e panegociueshme që hap dyert eTregut Unik Europian. Kjo pasaportë na jep zë të tregojmë historinë e origjinës, cilësisë dhe qëndrueshmërisë sonë, duke e kthyer rregullin në reputacion dhe reputacionin në mundësi.

Sot, po kalojmë nga politika në zbatim.

Angazhimi ynë është konkret: Po punojmë për ...

- Dixhitalizimin e proceseve të e-certifikimit;
- Pilotimine teknologjive të monitorimit;
- Përmirësimine bazave të të dhënave kombëtare.

Në të njëjtën kohë, po përgatisim masa fiskale mbështetëse dhe financime për të ndihmuar fermerët në këtë proces transformimi.

Gjej rastin të falenderoj UNIDO-n dhe SECO-n, që po mbështesin me ekspertizë dhe përvojë ndërkombëtare.

Por ky transformim kërkon aleancë kombëtare për cilësinë në disa nivele si ...

- Institucione kërkimore dhe akademike;
- Infrastrukturë cilësie dhe laboratorë me standarde;
- Sektori financiar dhe privat;

Së bashku ndërtojmë një sistem të vetëm, ku të dhënat lëvizin me siguri dhe integritet – nga ferma deri në kufirin europian.

Transformimi që po ndjekim është ambicioz, por i domosdoshëm. Fermerët tanë meritojnë të gjitha mundësitë për të konkurruar në kushte të barabarta.

Le të ecim përpara së bashku drejt një bujqësie moderne, të qëndrueshme dhe europiane.

Tryezat e negociatave për Kapitullin 11 dhe 12, janë shumë më tepër se kërkesa teknike; ato janë udhërrëfyese për modernizimin e sektorit tonë agro-ushqimor.

Në këtë proces, fjala që përçakton përparësinë dhe mundësinë tonë është gjurmueshmëria. Ajo është garancia jonë për sigurinë ushqimore, besimin e konsumatorit dhe hyrjen në tregjet europiane.

Gjurmimi është ura dixhitale që lidh fermerin shqiptar me

Shqipëria drejt rritjes së konkurrueshmërisë: Forumi i 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet vendos bazat për eksportet drejt BE-së

(Vijon nga faqja 3)

Forum i mbledhur me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, që ka për qëllim të ngratë kapacitetet e sektorit të agrobiznesit dhe të përmirësojë konkurrencën ndërkombëtare. Forumi mbledhur në Tiranë, më 15 nëntor 2025, ka për qëllim të ngratë kapacitetet e sektorit të agrobiznesit dhe të përmirësojë konkurrencën ndërkombëtare. Forumi mbledhur në Tiranë, më 15 nëntor 2025, ka për qëllim të ngratë kapacitetet e sektorit të agrobiznesit dhe të përmirësojë konkurrencën ndërkombëtare.

Salla: Gjurmueshmëria është “pasaporta europiane” e produkteve shqiptare
Ministri i Bujqësisë, Andis Salla, theksoi se digjitalizimi i proceseve të kontrollit dhe gjurmueshmërisë është thelbësor për konkurrencën ndërkombëtare:
“Gjurmimi është ura digjitale që lidh fermerin shqiptar me konsumatorin europian, pasaporta që hap dyert në tregun unik. Sot po kalojmë nga politika në zbatim dhe angazhimi ynë është konkret.”

Roli i Zvicrës dhe UNIDO: Cilësia është çelësi i besimit
Ambasadorja e Zvicrës, Ruth Huber, nënvizoi mbështetjen e Zvicrës për modernizimin e infrastrukturës së cilësisë në Shqipëri:
“Cilësia dhe standardet janë në zemër të detyrimeve të tregut europian. Ato janë më shumë se kërkesa teknike – përbëjnë themelin e besimit mes prodhuesve shqiptarë dhe konsumatorëve të BE-së.”
Programi Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), i financuar nga SECO dhe zbatuar nga UNIDO, po mbështet Shqipërinë me asistencë teknike, udhëzime për politika dhe trajnime për ndërmarrjet që synojnë certifikimet ndërkombëtare.

Koordinatorja Kombëtare e UNIDO&GQSP, Elvana Zhezha, theksoi se cilësia është “gur themeli i ambicieve ekonomike të Shqipërisë” dhe se mbështetja e bizneseve të vogla dhe të mesme në adoptimin e teknologjive moderne, përfshirë inteligjencën artificiale, është prioritet i programit.

Master i ri për cilësinë në Universitetin Bujqësor
Kontribut në këtë drejtim pritet të japë edhe arsimi i lartë. Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fatbardh Sallaku, njoftoi nisjen e një programi të ri master shkencor të dedikuar standardeve dhe sistemeve të cilësisë, i hartuar në bashkëpunim me UNIDO.

KASH: Bashkëpunim publik–privat për Shqipërinë në BE në 2030-n
Kryetari i KASH-it, Agim Rrapaj theksoi rëndësinë e kohezionit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat:
“Problemet e cilësisë dhe standardeve kapërcehen më lehtë duke punuar së bashku, me objektiva të qarta, me synim Shqipërinë anëtare të BE në 2030-n.”

Forum i zhvilluar paralelisht me Kongresin e 5-të të KASH-it
I organizuar paralelisht me Kongresin e 5-të të KASH-it, Forumi bashkoi prodhues, institucione shtetërore, ekspertë dhe partnerë ndërkombëtarë për të adresuar sfidat dhe mundësitë që lidhen me konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregun e vetëm europian.

REZOLUTË E KONGRESIT TË V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

(Vijon nga faqja 2)

bujqësore me leje qarkullimi dhe targa (amendim në Kodin Rugor).

3. Përmirësimi i Ligjit nr. 62/2012 “Për Akcizat”, për të mundësuar karburant me çmim të reduktuar për subjektet bujqësore.

4. Mbështetja e Qendrave të Agroservisit për importin dhe përshtatjen e makinerive moderne.

Masat e Qeverisë (Status 2025)

- Në zbatim është skema e subvencionimit 50% për makineritë bujqësore (VKM nr. 485/2025).
- Regjistri Kombëtar i Mekanikës nuk është ende miratuar me akt ligjor.
- Qeveria ka sinjalizuar se do të përfshijë këtë mekanizëm në Paketën e Bujqësisë 2026.
- KASH propozon shumëvjeçarizimin e skemës dhe integrimin e të dhënave në sistemet fiskale për përdorim si garanci financiare.

III. FINANCIMI DHE DISBURSIMI I FONDEVE GRANT Sfidat aktuale

Financimi i bujqësisë mbetet nën nivelin e nevojshëm. Buxheti publik për bujqësinë përbën vetëm 1.8–2.1% të shpenzimeve kombëtare, ndërsa kreditimi nga bankat nuk kalon 2% të totalit.

Programet e BE-së (IPARD II dhe III) kanë hasur vonesa në disbursim dhe mungesë transparence për fermerët.

Propozimet e KASH

- Nisja e disbursimeve të IPARD III brenda 6-mujorit të parë të 2026.
- Dyfishimi i Skemës Kombëtare të Mbështetjes dhe kallimi në financim për njësi prodhimi.
- Trajtimi i mikrofinancave (p.sh. FED Invest) në të njëjtin nivel me bankat e nivelit të dytë për Garancinë Sovrane.
- Modeli i ri i kolateralit, ku kontratat e furnizimit dhe prodhimet e magazinuara shërbejnë si garanci.

Masat e Qeverisë (Status 2025)

- Është shpallur linja 250 milionë euro për NVM-të dhe Garancia Sovrane 30 milionë euro.
- Përfshirja e plotë e mikrofinancës ende nuk është formalizuar me akt të veçantë nga BSH.
- IPARD III pritet të fillojë në 2026 pas auditit të BE-së.
- Skema Kombëtare 2025 ka ruajtur të njëjtin nivel fondesh; KASH kërkon rritje me 100% në 2026.

IV. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR DHE PËRAFRIMI ME BE
Sfidat aktuale
Procesi i përafrimit të legjislacionit me acquis

communautaire mbetet i ngadalshëm.

Kërkesat e KASH për ndryshimin e ligjeve themelore (për kooperimin, akcizat, TVSH-në, zhvillimin rural dhe standardet) janë trajtuar pjesërisht dhe pa kalendar zbatimi.

Propozimet e KASH

- Amendimi i Ligjit nr. 38/2012 “Për SHBB” (riformulim i plotë).
- Amendimi i Ligjit nr. 92/2014 “Për TVSH”, për unifikim të pagesës dhe rimbursimit.
- Amendimi i Ligjit nr. 62/2012 “Për Akcizat” (karburanti bujqësor).
- Amendimi i Ligjit nr. 9817/2007 “Për Zhvillimin Rural”, për të mundësuar bashkëpunimin publik–privat.
- Hartimi i Ligjit të ri për Sigurimin e Pronës dhe Prodhimit Bujqësor.

Masat e Qeverisë (Status 2025)

- Rishikimi i Ligjit 38/2012 është në proces konsultimi me FAO.
- Kompensimi 10% i TVSH-së për fermerët është përfshirë në Paketën Fiskale 2026, por ende pa efekt zbatimi.
- Ligji për sigurimet bujqësore është në përgatitje, me synim pilotimin në 2026.
- Nuk ka nismë për faljen e detyrimeve të prapambetura të fondeve grant.

V. KONKLUZIONE DHE ANGAZHIME

Kongresi i V i KASH riafirmon rolin e tij si platformë e përbashkët e agrobiznesit shqiptar dhe partner strategjik i institucioneve shtetërore për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe agroindustrisë.

Qartësimi i afateve të zbatimit dhe instrumenteve mbështetëse është thelbësor që propozimet e KASH të mos mbeten deklarative, por të përkthehen në rezultate të matshme në fermë dhe industri.

REZOLUTA E KONGRESIT TË V TË KASH (Kërkesa për Veprim të Menjëhershëm)

1. URGJENCË FINANCIARE DHE FISKALE

- Falja e gjobave dhe kamatëvonesave për 104 SHBB-të.
- Fillimi i financimit për njësi prodhimi në Skemën Kombëtare 2026.
- Përfshirja e plotë e mikrofinancës në Garancinë Sovrane dhe Fondin e BSH.

2. URGJENCË LEGJISLATIVE

- Trajtimi me urgjencë në Kuvend i paketës së amendimeve ligjore (Ligjet 38/2012, 92/2014, 62/2012, 9817/2007).
- Hartimi i Ligjit të ri për Sigurimin e Prodhimit dhe Pronës, me miratim brenda vitit 2026.

3. PRIORITET IPARD III

- Fillimi i disbursimit të fondeve brenda 6-mujorit të parë të 2026.
- Publikimi i kalendarit të thirrjeve dhe raportim publik për transparencë.

4. REFORMË E STRUKTURAVE DHE KOORDINIMIT

- Ngritja e strukturës së posaçme për kooperimin në MBZHR.
- Funksionalizimi i Librit Kombëtar të Mekanikës Bujqësore dhe Qendrës së Regjistrimit të Fermerëve.
- Thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit për kualifikimin e drejtuesve të grupimeve.

INDIKATORË MONITORIMI (2026)

- TVSH: ≥80% e kërkesave të rimbursimit të fermerëve paguhen brenda 30 ditësh.
- IPARD III: ≥35% e fondeve të thirrjeve 2026 kontraktohen brenda vitit.
- Mekanizim: ≥1,500 njësi makinerish të reja të regjistruara.
- Kooperim: ≥30 SHBB të certifikuara sipas kriterëve të reja.
- Sigurime bujqësore: ≥500 kontrata aktive në skemat pilot.

BILANCI I 25 VITEVE TË KASH

Në 25 vite veprimtarie, KASH ka ndërtuar një rrjet të qëndrueshëm në të gjithë territorin e vendit prej 37 shoqatash e Këshillash Rajonale të Agrobiznesit dhe 104 SHBB-shë. Ka organizuar mbi 200 trajnime, 5 kongrese dhe dhjetëra tryeza sektoriale, duke ndikuar në politikat që prekin mbi 100 mijë fermerë e agropërpunues në gjithë vendin. Boton dy herë në muaj në print dhe në formë elektronike, për 25 vjet Gazetën Agrobiznesi me 16 faqe. Gjithashtu ka organizuar disa panaire kombëtare dhe ndërkombëtare për mekanizimin, inovacionin dhe dixhitalizimin.

Kjo përvojë e konsoliduar është garancia që propozimet e KASH mbeten realiste, të zbatueshme dhe të përputhura me drejtimin europian të bujqësisë shqiptare.

RAPORT PËR KONGRESIN E V TË KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR (KASH)

(Vijon nga faqja 2)

punësimi në atë periudhë të ish-drejtnesit të organizatës në stafin politik të Ministrisë, si dhe ndërprerja e projekteve madhore të asistencës teknike dhe financiare (p.sh., projektet e JICA).

Kongresi IV, i mbajtur më 16 Maj 2015, përcaktoi katër shtyllat strategjike të zhvillimit (Kooperimi, Mekanizimi, Financimi dhe Legjislacioni). Ky kongres shënoi rritjen e anëtarëve në 37 shoqata dhe rritjen e Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) në 104. Sfidë thelbësore mbeti mosvlerësimi i propozimeve të KASH për amendimin e Ligjit 38/2012 për SHBB-të dhe suprimimi i shpejtë i sektorit të posaçëm të kooperimit dhe bashkëpunimit të krijuar në MBZHR.

Këto katër kongrese krijuan bazën mbi të cilën ndërtohet ky raport: Kooperimi, Mekanizimi, Financimi dhe Legjislacioni si boshtet e zhvillimit.

VLERËSIMI I SFIDAVE TË SOTME DHE PROPOZIMET E KASH (2015-2025)

Sfidat madhore që kërkojnë zgjidhje efektive, të cilat ndikojnë negativisht edhe në cilësinë, sigurinë e konsumatorit dhe përafrimin e standarteve tona me standardet e BE-së, janë grupuar në katër shtylla strategjike.

III.1. Shtylla 1: Procesi i Bashkëpunimit dhe Koordinimit

Sfida Thelbësore

Bllokimi kryesor vjen nga fragmentarizimi i tokës (1.8 milionë parcela nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991) dhe dështimi i funksionimit të Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB). Ligji nr. 38/2012 “Për SHBB” ka rezultuar jo dobiprurës për shkak të: mungesës së mbështetjes strukturore në Ministri, konkurrencës së pandershme, mungesës së politikave lehtësuese fiskale dhe efekteve dëmtuese të gjobave ndaj 104 SHBB-ve të sapokrijuara. Për më tepër, NIPT-i aktual i fermerit vlerësohet si jo i vlefshëm për disbursimin e fondeve grant të BE-së.

Kërkesat e KASH

Kërkohet urgjentisht: Ngritja e një strukture të posaçme brenda MBZHR-së për mbështetjen e bashkëpunimit. KASH kërkon Faljen urgjente e gjobave dhe kamatëvonesave të vendosura nga Dogana dhe Tatimet për 104 SHBB-të e ndëshkuara. Në fushën formative, kërkohet që Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, të hartojë kurrikula për kualifikimin e stafeve drejtuese të SHBB-ve dhe Grupimeve Vendore të Veprimit (GVV). Sa i përket formalizimit, duhet përmirësuar Programi i regjistrimit të subjekteve në QKB, duke mundësuar regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e SHBB-ve si dhe të Federatave/Konfederatave të tyre, ose krijimi i një Qendre të re Regjistrimi për subjektet e Agrobiznesit.

Status 2025: MBZHR ka nisur me FAO procesin e rishikimit të Ligjit 38/2012 (në proces konsultimi). Nuk ka akt për amnisti fiskale të gjobave për 104 SHBB. Zgjidhja për NIPT-in e fermerit dhe regjistrin e posaçëm mbetet në diskutim teknik, pa afat të shpallur zbatimi.

III.2. Shtylla 2: Fusha e Mekanizimit, Inovacionit dhe Digjitalizimit

Sfida Thelbësore

Sektori vuan nga parku i amortizuar i mjeteve bujqësore (mbi 25 vjet), i papërshtatshëm për terrenin kodrinoromalor. Kjo rezulton në një shkallë mekanizimi shumë të ulët: 1.24 traktorë/100 ha (kundrejt mesatares së BE-së prej 8.1 traktorë/100 ha). Kjo shkakton kosto të lartë dhe informalitet. Vështirësi shtesë paraqet edhe mos-përdorimi i mjeteve bujqësore si kolateral për shkak të mungesës së regjistrimit të tyre.

Kërkesat e KASH

Kërkesat kryesore janë: Hartimi i një Libri Kombëtar për regjistrimin e mjeteve të mekanikës bujqësore, me qëllim që mjetet të përdoren edhe si garanci për financim. Kërkohet mbështetja e Qendrave të Agroservisit për rinovimin e parkut të mjeteve. Për formalizimin e qarkullimit (kërkesë për amendimin e Kodit Rrugor), duhet të pajisen drejtuesit e mjeteve bujqësore me dokumentet e nevojshme (leje drejtimi, leje qarkullimi, targa). Së fundmi, kërkohet përmirësimi i praktikës ekzistuese të furnizimit me karburant me çmim të reduktuar (kërkesë për amendimin e Ligjit nr. 62/2012 “Për akcizat”).

Status 2025: Skema e mekanizimit 50% për makineri të reja është në zbatim. Regjistri Kombëtar i Mekanikës Bujqësore dhe standardet e targimit/certifikimit nuk janë adresuar ende me akt të posaçëm.

III.3. Shtylla 3: Fusha e Financimit dhe Disbursimit të Fondeve Grant

Sfida Thelbësore

Sektori është i nënfinancuar. Buxheti i Shtetit për bujqësinë (1.8 – 2.1% e shpenzimeve) dhe kreditimi nga bankat (rreth 2% e totalit) janë të pamjaftueshme. Problematike mbetet Ngrirja e përkohshme e disbursimit të IPARD II dhe vonesat në fillimin e IPARD III, si dhe fakti që rreth 72% e fermerëve individualë nuk kanë akses në financime për shkak të statusit të tyre.

Kërkesat e KASH

Kërkohet: Marrja e masave për fillimin e disbursimit të IPARD III brenda 6-mujorit të parë të vitit 2026. Për Buxhetin Kombëtar, kërkohet rishikimi i programit afatmesëm me synim dyfishimin e shumës së Skemës Kombëtare, si dhe fillimi i financimit për njësi prodhimi (duke filluar me produktet e cilësisë së parë). Për aksesin në kredi, kërkohet trajtimi i shoqërive të mikrofinancës, si FED Invest, në të njëjtin nivel me bankat e nivelit të dytë për Garancinë Sovrane. Për 72% e fermerëve individualë, propozohet modeli i ri i kolateralit, ku kontrata e shërbimit dhe prodhimi i magazinuar të shërbejnë si kolateral, me zgjidhje të mosmarrëveshjeve përmes Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit.

Status 2025: Qeveria/BSH kanë shpallur linjën 250 milion€ për NVM dhe garanci 30 milion€; përfshirja e plotë e mikrofinancave në të njëjtin regjim me bankat kërkon udhëzim të dedikuar. IPARD III pritet të hapet në 2026, pas konfirmimit të auditit të BE-së. Dyfishimi i Skemës Kombëtare është në diskutim buxhetor, pa vendim.

III.4. Shtylla 4: Fusha e Legjislacionit dhe Përafrimi me BE-në

Sfida Thelbësore

Pavarësisht kërkesave të përsëritura të KASH, amendimet e ligjeve thelbësore (për Kooperimin, Akcizat, TVSH-në, Zhvillimin Rural dhe Standardet) nuk janë miratuar, duke penguar procesin e përafrimit me acquis komunitar. Këto kërkesa mbeten: Amendimi i Ligjit nr. 38/2012 (SHBB), Amendimi i Ligjit nr. 92/2014 (TVSH), Amendimi i Ligjit nr. 62/2012 (Akcizat), Amendimi i Ligjit nr. 9817/2007 (Zhvillimi Rural) dhe Hartimi i Ligjit të ri për Sigurimin e Prodhimit dhe Pronës.

Kërkesat e KASH

Kërkesa kryesore është që amendimet e ligjeve të lartpërmendura të përgatiten dhe të kalojnë për miratim në Kuvend si një paketë e posaçme me urgjencë. Gjithashtu, kërkohet hartimi dhe miratimi i një ligji të ri për Sigurimin e pronës dhe prodhimit, si dhe hartimi i një ligji për faljen e detyrimeve të prapambetura të fondeve grant të donatorëve.

Status 2025: Paketimi i amendimeve (Ligji 38/2012; 92/2014; 62/2012; 9817/2007) është në diskutim ndërinstitucional, pa projektligj të depozituar. Ligji i sigurimit bujqësor është në fazë konceptuale me asistencë teknike; synohet miratim në 2026. Nuk ka ndryshim të shpallur për faljen e detyrimeve të prapambetura.

VLERËSIMI I MASAVE TË NDËRMARRA NGA QEVERIA NË RAPORT ME PROPOZIMET E KASH (Përditësim 2025)

Në fund të vitit 2025, vlerësimi i KASH evidenton përgjigje të pjesshme ndaj propozimeve, me masa në zbatim, masa në proces miratimi dhe boshllëqe që kërkojnë afate të qarta zbatimi.

Në fushën e Financimit, qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë. Kërkesa për zhbllokimin e fondeve IPARD III është adresuar me pritshmërinë e hapjes së thirrjeve në vitin 2026. Ky status mbetet në përputhje kohore, por varet nga auditimi i BE-së në vjeshtën e vitit 2025. Gjithashtu, kërkesa e KASH për lehtësi në kreditim u adresua me lëshimin e linjës së financimit 250 milionë euro dhe Garancisë Sovrane 30 milionë euro. Megjithatë, kjo masë vlerësohet si e adresuar pjesërisht, pasi përfshirja e plotë e mikrofinancës (si FED Invest) në skemën lehtësuese ende nuk është konfirmuar plotësisht.

Lidhur me lehtësimet fiskale, kompensimi 10% i TVSH-

së për fermerët është përfshirë në Paketën Fiskale 2026; nuk është ende në fuqi dhe priten aktet nënligjore/udhëzimet për rimbursimin.

Në fushën e Mekanizimit, miratimi i subvencionit 50% për makineritë e reja bujqësore është një hap konkret drejt propozimeve të KASH. Megjithatë, kërkesa thelbësore për krijimin e një Regjistri Kombëtar të Mekanikës Bujqësore si mjet kolateralizimi dhe formalizimi nuk është adresuar ligjërisht.

KASH propozon shumëvjeçarizimin e skemës 50% dhe krijimin e Regjistrit Kombëtar të Mekanikës, që mundëson kolateral, sigurim dhe statistika zyrtare.

Për Kooperimin dhe Legjislacionin, Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me FAO-n, ka nisur procesin e rishikimit të Ligjit 38/2012 për SHBB-të dhe ka vënë në diskutim një ligj të ri për Sigurimin Bujqësor (i cili pritet të miratohet në vitin 2026). Këto janë hapa në proces drejt përmbushjes së kërkesave legjislative të KASH. Sidoqoftë, kërkesa me ndikim të menjëhershëm, si Amnistia Fiskale për faljen e gjobave të 104 SHBB-ve, nuk është adresuar me asnjë akt zyrtar deri në këtë Kongres.

MASAT NË PROCES DHE AFATET 2026–2030

- IPARD III (2026): kalendar thirrjesh i publikuar + objektiva vjetore të kontraktimit/disbursimit;
- TVSH 10% (kompensim): aktet nënligjore dhe afat rimbursimi ≤30 ditë nga depozitimi;
- Mekanizimi 50%: shumëvjeçarizim i skemës + Regjistër Kombëtar i Mekanikës;
- Ligji 38/2012 (SHBB): afat miratimi dhe njësi e kooperimit në MBZHR;
- Sigurimi bujqësor: pilotim në 2–3 zona me risk klimatik, me prime të subvencionuara.

PËRFUNDIME DHE REZOLUTA E KONGRESIT V

Raporti i Kongresit V konfirmon sfidat e mëdha dhe shpreh shqetësimin për zbatimin e vonuar të disa propozimeve të KASH. Nevojitet urgjentisht një harmonizim i plotë institucional për të kapërcyer ndikimet negative të informalitetit dhe nënfinancimit.

Pavarësisht nismave të fundit qeveritare, theksi i Kongresit mbetet te katër pikat kyçe të Rezolutës.

Qartësimi i afateve dhe instrumenteve zbatues është kusht që propozimet e KASH të mos mbeten deklarative, por të kthehen në rezultate të matshme në fermë dhe industri.

REZOLUTA E KONGRESIT V TË KASH (Kërkesa për Veprim të Menjëhershëm)

- URGJENCË FINANCIARE DHE FISKALE: Kërkohet Falja e Gjobave dhe Kamatëvonesave të vendosura për 104 SHBB-të, si masë e besimit të Qeverisë ndaj Kooperimit. Të fillojë financimi për njësi prodhimi në Skemën Kombëtare (duke filluar me produktet e cilësisë së parë). Gjithashtu, të sigurohet përfshirja e plotë e Mikrofinancës (FED Invest) në Garancinë Sovrane dhe Fondin e BSH.
- URGJENCË LEGJISLATIVE: Kërkohet trajtimi me urgjencë në Kuvend i Paketës së Posaçme të Amendimeve Legjislative (Ligjet 38/2012, 92/2014, 62/2012, 9817/2007) dhe hartimi i Ligjit të ri për Sigurimin e Prodhimit dhe Pronës, duke synuar miratimin e tyre brenda vitit 2026.
- PRIORITET IPARD: Të angazhohen të gjitha palët për fillimin e disbursimit të IPARD III brenda afatit të kërkuar të 6-mujorit të parë të vitit 2026, duke siguruar transparencë maksimale.
- REFORMË E STRUKTURAVE: Kërkohet ngritja e strukturës së posaçme në MBZHR për Kooperimin dhe Koordinimin. Të funksionalizohet Libri Kombëtar i Mekanikës Bujqësore dhe Qendra e Regjistrimit të Fermerëve (përfshirë Federatat). Të thellohet bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit për kualifikimin e stafeve drejtuese të grupimeve.

Indikatorë monitorimi për 2026

- TVSH: ≥80% e kërkesave të rimbursimit paguhen brenda 30 ditësh;
- IPARD III: ≥35% e fondeve të thirrjeve 2026 kontraktohen brenda vitit;
- Mekanizim: ≥1,500 njësi makinerish të reja të regjistruara;
- Kooperim (SHBB): ≥30 SHBB të certifikuara sipas kriterëve të reja;
- Sigurime bujqësore: ≥500 kontrata aktive në skemat pilot.

Rezoluta e dalë nga punimet e këtij kongresi specifikon më gjerësisht kërkesat dhe indikatorët përkatës .

TEMA TË DITËS

Fjala përshëndetëse e kreut të KASH-it, Agim Rrapaj, në konferencën e tretë të programit GQSP–UNIDO

I nderuar Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Z. Salla,

E nderuar shkëlqesia Juaj Ambasadore e Zvicrës Znj. Huber,

Të nderuar Zv/ Min Z. Kote, Z. Jaupllari, Z. Guri,

I nderuar Rektor i UBT Prof. Sallaku, I nderuar Rektor i Univ. Egerem Cabej, Prof. Dr. Cana, E nderuar Profesoreshë Hoxhaj, I nderuar Prof. Uka!

I nderuar Inspektor i Përgjithshëm i Kontrollit Z. Hajdari,

E nderuar Znj. Muçostepa Kryetare e Bashkimit të dhomave të tregtisë dhe Industrisë, I nderuar Z. Bregasi President i Biznes Albania, I nderuar Z. Shkodra Sekretar i Këshillit Ekonomik Kombëtar, I nderuar Z. Fejzi Përfaqësues Forumit Ekonomik Kombëtar,

E nderuar Znj. Zhezha Kordinatore e Progarmit Kombëtar për Cilësi dhe Standarde, Z. Beqiri Kordinator i Programit për Tregëtinë Ndërkombëtare, Z. Stefanllari e Z. Osmani, drejtues të Projektit Risi Albania, Përfaqësues të Projektit GIZ, Z. Molla kordinator i projektit të BB Qendrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimi Bujqësisë.

Të nderuar kolege dhe kolegë të mi Kryetarë të shoqatave kombëtare dhe Këshillave Rajonale të Agrobiznesit,

Të nderuar miq të KASH, ekspertë e përfaqësues të sektorit të Bujqësisë, Blegtorisë, Peshkimit dhe Akuakulturës, Agrobiznesit dhe Tregjeve Agro – Blegtorale, Agropëpunimit dhe Subjekteve të ushqimit social, Turizmit rural, Agropylltarisë dhe Mjedisit, Bimëve Mjekësore & Aromatike”, Bujqësisë biologjike dhe Bletarisë”, te Finances dhe Mikrofinancës.

Mirë se keni ardhur në punimet e Konferencës së tretë të Programit kombëtar për cilësi dhe standarde dhe në Kongresin e V të KASH, që të diskutojmë së bashku për Cilësinë, Sigurinë për konsumatorët dhe Standartet. Vendosëm që ta organizojmë së bashku aktivitetin me këtë program të UNIDO-s sepse realizimi i objektivave për këtë trinom na kërkon që të punojmë njëkohësisht, në front, të mirëkoordinuar dhe të bashkuar,

KASH 2 vite më parë me mbështetje të MBZHR dhe strukturave të saj të vartësisë, në bashkëpunim me profesorë dhe studentë të UBT, të financuar grant nga qeveria dhe taksapaguesit Zviceranë përmes SECO dhe Projektit RISI Albania e trajtuam këtë temë për ulla dhe vajin e ullirit. Organizuam 23 takime me subjektet që punojnë në terren dhe jo vetëm, Realizuam mbi 300 analiza laboratorike për të evidentuar cilësinë e vajit të ullirit. Prodhimi ullirit ishte i bollshëm dhe llogaritej rreth 30 mijë ton vaj ulliri. Çmimi shitjes së vajit ishte mesatarisht 3.5 - 4 euro/litër. Nga analizat na rezultoi se 34 % e vajit të ullirit ose 10 mijë ton ishte extra i virgjër, por edhe kjo sasi shitej me 3.5-4 euro/kg me shumicë sepse ishte e pacertifikuar dhe e pastandardizuar. Fermerët përfitonin nga kjo sasi 35-40 milion euro. Në rast se kjo sasi vaji do të shitej në treg si vaj extra i virgjër me çmimin 10-12 euro/litër përveç përfitimit për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit, vlera financiare që do të përfitonin fermerët do të rritej nga 35-40 milion euro në 100 -120 milion euro dhe me një treg të garantuar për shitje.

Ne jo vetëm që kuptuam por dhe e pro-
vuam se çfarë rezerve të mundshme por të papërdorur kemi tek Cilësia, dhe stan-

dardet. Gjithashtu me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës u bë e mundur ngritja dhe funksionimi i grupit teknik të punës për koordinimin e veprimtarisë për certifikatën e cilësisë Global Gap. Si rezultat i një pune intensive sipërfaqja e certifikuar me Global Gap u 10 fishua. U lehtësua dhe garantua shitja e produkteve tona në tregjet e BE. Ambasada zvicerane përmes programit Global për Cilësi dhe Standarde të UNIDO-s po na asiston edhe për informimin e gjithanshëm të fermerëve përmes artikujve të botuar në Gazetën Agrobiznesi. Gjithashtu po na asiston edhe në Procesin e kooperimit, për themelimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) në katër qarqe në Shkodër, Korçë, Berat dhe Vlorë. Grupe Veprimi në të cilat marrin pjesë bashkitë, akademia dhe agrobiznesi. Universitetit Bujqësor të Tiranës i është përgatitur dhe dorëzuar edhe një program digjital mjaft dobiprurës për të përmirësuar punën për cilësinë, sigurinë e konsumatorit dhe standartet, i cili duhet ndihmuar financiarisht për ta futur në proces zbatimi sa më parë të jetë e mundur. KASH e vlerëson shumë ndihmën e dhënë nga taksapaguesit dhe qeveria e Zvicrës dhe ju falenderojmë me shumë mirënjohje shkëlqesia Juaj Ambasadorja Huber!

KASH beson dhe e vlerëson shumë rëndësinë dhe dobinë që ka konsolidimi i procesit të kooperimit dhe bashkëpunimit për të rritur eficientë e pronës së subjekteve të Fushës së Ekonomisë së Ushqimit. Procesi është i dobishëm për pronën e fermerëve që ushtrojnë aktivitet individual dhe prodhojnë sasi produktesh vetëm për vetëkonsum. Atyre që prodhojnë për vetëkonsum, por u mbetet një tepriçë produkti për treg dhe për grupin e subjekteve të mirëorganizuar që prodhojnë për tregun e vendit dhe për eksport.

Referuar treguesve të ndarjes së tokës sipas ligjit 7501 “Për Tokën” rezultojnë të regjistruar si përfitues të tokës dhe aseteve të tjera 354 mijë fermerë. Grupet e fermerëve që prodhojnë vetëm për vetëkonsum dhe u mbetet një tepriçë prodhimi për treg zënë 72 % të totalit dhe 28 % e zë grupi tretë që prodhon dhe furnizon tregun e vendit dhe eksportin. Tregu i shitblerjes së tokës dhe dhënia me qera nuk ka funksionuar dhe parashikohet të mos funksionojë edhe për një kohë të gjatë në të ardhmen. Veprimtaria e 104 SHBB të regjistruara në QKB nuk rezultoi eficiente. Sektorë të rëndësishëm të Ekonomisë së Ushqimit si bujqësia dhe blegtoria kanë probleme që duhen zgjidhur sepse nuk po na japin rezultate pozitive kohët e fundit.

KASH mendon se zgjidhja e problemeve dhe vështirësive që ndeshim për Cilësinë, sigurinë e konsumatorit dhe standartet ,kapërcehen më lehtë duke punuar së bashku, të mirëkoordinuar sektori publik me atë privat, me objektiva të qarta me synim Shqipërinë anëtare në BE, në 2030. Realizimi i këtij objektiv madhor është i lidhur ngushtësisht me punën që do të bëjmë dhe rezultatet që do të arrijmë në katër shtylla kryesore: Në Procesin e Kooperimit, Fushën e Mekanizimit, Inovacionit dhe Digjitalizimit, Fushës së financës dhe Disbursimit të Fondeve Grant, Fushës së Legjislacionit dhe përafrimit me atë të BE. Për këto më gjerësisht të nderuar pjesëmarrës do të flasim në vijim në Kongresin e V të KASH.

Faleminderit shumë dhe Uroj një ditë të mbarë dhe me rezultate dobiprurëse në fund të saj.

Salla: Përmbytje të lokalizuara në Lezhë e Durrës, hidrovoret në kapacitet të plotë

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andi Salla deklaroi se strukturat në terren po monitorojnë nga afër situatën e krijuar nga reshjet intensive të 48 orëve të fundit, që kanë shkaktuar rritje të niveleve të ujit në lumenj dhe kanalet kulluese.

Salla bëri të ditur se në disa zona, kryesisht në qarkun

Salla bëri të ditur se, në Qarkun Lezhë, në njësinë administrative Mamurras, për shkak të prurjeve të mëdha të lumit Droje dhe dëmtimit të një segmenti të argjinaturës, janë përmbytur toka bujqësore dhe disa zona të banuara përgjatë të dy brigjeve, veçanërisht në Thumanë dhe Dukagjin.



e Lezhës dhe Durrësit, janë shënuar përmbytje të tokave bujqësore dhe vështirësi në ndërhyrje, ndërsa hidrovoret në ultësirën perëndimore vijnë punën me kapacitet të plotë.

“Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Durrës ka dislokuar dy mjete të rënda pranë segmentit të dëmtuar, por ndërhyrja mbetet e vështirë për shkak të niveleve të larta të ujit. Në

zonën e Lezhës, megjithëse kanalet kulluese dhe hidrovoret kanë nivele të larta uji, situata paraqitet e qëndrueshme, me përmbytje të lokalizuara. Ndërkohë hidrovoret në Kurbin dhe Lezhë vijojnë punën normalisht. Ndërsa nivelet e ujit në lumenjtë Drin dhe Mat janë ulur me rreth 50 cm”, u shpreh ministri.

Në Qarkun Durrës, tha ai, situata mbetet e ndërlikuar, sidomos në zonën e Hamallajt.

Ka një ulje të nivelit të ujit me rreth 50 cm në Hamallaj dhe në kanalin e ujërave të larta “Tone”.

Salla tha se është konstatuar rritje e niveleve në lumenjtë: Shkumbin, Seman, Vjosë, Shushicë, Drinos, Pavlla e Madhe, Pavlla e Vogël, Bistrica e Madhe dhe Bistrica e Vogël.

Aktualisht rrjedhat janë brenda shtratit, përveç lumit të Kalasës, i cili mbi urën e Gajdarit ka dalë nga shtrati dhe ka shkaktuar përmbytje, duke bllokuar segmentin rrugor kombëtar Sarandë-Delvinë.

Salla u shpreh se, të gjitha hidrovoret në ultësirën perëndimore, përfshirë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Rogozhinë, Lushnje, Divjakë, Fier, Vlorë dhe Sarandë, janë në funksion të plotë dhe po punojnë për shkarkimin maksimal të ujërave.

Ministri Salla theksoi se strukturat emergjente janë vazhdimisht në terren, ndërsa qytetarët ftohen të respektojnë masat e sigurisë dhe të shmangin zonat e përmbytura.

Sipërmarrja e gjelbër: Bio-Waste Innovation Challenge prezanton 11 ide innovative për trajtimin e mbetjeve bio

11 kompani vendase prezantuan zgjidhje inovative për menaxhimin e mbetjeve bio në kuadër të thirrjes kombëtare

në vlerë deri në 200,000 EUR, për të testuar zgjidhjet e tyre në kushte reale tregu, një hap konkret drejt



Bio-Waste Innovation Challenge, mbështetur nga programi Programi BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme.

4 Kompanite fituese AL BM, Il Verde, SoRiZa dhe Albanian Black Soldier Fly (ALBSF) përfitojnë grante

punësimit të gjelbër, investimeve lokale dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe ekonomisë qarkulluese. Propozimet përfshijnë zgjidhje innovative në trajtimin e mbetjeve bio përmes metodave të shumta të kompostimit kryesisht në bashkitë Divjakë,

Lushnjë dhe Krujë.

Ky aktivitet dëshmon se inovacioni dhe sipërmarrja mund të transformojnë sektorin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, duke reduktuar ndikimin në mjedis dhe duke cuar përpara negociatat për anëtarësim në BE, vecanërisht Kapitullin 27.

Ministri i Mjedisit Sofjan Jaupaj gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve vlerësoi rolin e sektorit privat në menaxhimin e mbetjeve në vend dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike si një hap i rëndësishëm drejt integritetit të vendit në BE.

Mbetjet organike përbëjnë rreth 60% të mbetjeve bashkiake në Shqipëri, por ato mbeten kryesisht të patrajtuara. Zgjidhjet e prezantuara ofrojnë mënyra praktike për trajtimin e tyre, duke ulur përdorimin e vend-depozitimeve dhe emetimet e gazeve

Nga Fusha në Magazinë - Si të Ruajmë Cilësinë e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Bimët aromatike dhe mjekësore (MAPs) përfaqësojnë një nga pasuritë më të mëdha natyrore të Shqipërisë dhe një burim të rëndësishëm të të ardhurave për mijëra familje në zonat rurale. Kërkesa e lartë nga tregjet ndërkombëtare, veçanërisht nga Bashkimi Europian, e ka kthyer këtë sektor në një motor të rëndësishëm ekonomik. Por që prodhimet shqiptare të jenë të konkurrueshme dhe të pranueshme në tregjet e huaja, cilësia duhet të ruhet jo vetëm në fushë — por në çdo hap të procesit, deri në momentin kur produkti futet në qeset grimcuese ose në kontenierët e eksportit.

Ruajtja e cilësisë së bimëve aromatike është një zinxhir i tërë procesesh që fillon me korrijen dhe përfundon me magazinimin. Çdo hap ka rëndësinë e vet, dhe një gabim i vogël mund të ndikojë në aromë, ngjyrë, pastërti dhe përmbajtje të vajrave esencialë — elementët që e bëjnë produktin të vlefshëm në tregun ndërkombëtar.

Koha e korrijes: fillimi i rrugës drejt cilësisë
Momenti i korrijes është vendimtar. Ekspertët rekomandojnë që bimët të mblidhen në ditë të thata dhe në mëngjes, pasi të jetë tharë vesa. Kjo fazë ruan përqendrimin optimal të vajrave esencialë — substanca që i japin bimëve aromën dhe vlerat e tyre bioaktive.

Korrja gjatë orëve të nxehta të ditës, e cila është ende praktikë e disa zonave, ul ndjeshëm cilësinë. Nxehtësia shkakton avullimin e vajrave esencialë dhe bima humbet aromën karakteristike, çka ul vlerën e saj tregtare.

Pas korrijes: nga fusha drejt tharjes pa humbur aromën

Pasi bimët mblidhen, mbrojtja e tyre nga dëmtimet mekanike dhe ndotja bëhet prioritet. Transporti duhet bërë në enë të pastra dhe të ajrosura, duke shmangur shtypjen apo komprimimin e bimëve. Në këtë fazë, çdo minutë ka rëndësi, sepse gjatë kohës që bima pret për t’u tharë, rritet rreziku i fermentimit dhe i humbjes së komponimeve të vlefshme.

Idealja është që tharja të nisë sa më shpejt pas korrijes. Ky është një moment ku shumë fermerë hasin vështirësi për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe ambienteve të dedikuara për tharje.

Tharja: procesi ku vendoset fati i cilësisë

Tharja e saktë është një nga hallkat që ndikon më fort në cilësinë përfundimtare. Në Shqipëri, ky proces kryhet ende shpesh në mënyrë tradicionale, por kërkon kujdes të madh.

Ekspertët rekomandojnë temperaturë 30–40°C, varësisht nga lloji i bimës, dhe një ambient të errët, të thatë dhe të ajrosur mirë. Tharja në temperatura të larta mund të dëmtojë ndjeshëm vajrat esencialë, duke e bërë produktin të humbasë aromën e natyrshme. Po ashtu, tharja e pakontrolluar rrit rrezikun e formimit të mykut.

Përdorimi i tharëseve industriale ofron një kontroll më të saktë, por kërkon investime. Disa ndërmarrje shqiptare po e bëjnë këtë hap, duke modernizuar procesin dhe duke rritur cilësinë e produkteve të tyre.

Pastrimi dhe klasifikimi: standardi që kërkon tregu europian

Pasi bimët janë tharë, ato kalojnë në fazën e pastrimit dhe klasifikimit. Papastërtitë, gjethet e dëmtuara dhe materialet e huaja duhet të hiqen plotësisht, në mënyrë që produkti të plotësojë standardet e BE-së.

Klasifikimi sipas ngjyrës, madhësisë dhe cilësisë është thelbësor për rritjen e vlerës së produktit dhe krijimin e lotëve homogjenë. Çdo lot duhet të ketë dokumentacion të qartë për gjurmueshmëri — kërkesë e domosdoshme në tregjet perëndimore dhe në sistemet moderne të sigurisë ushqimore.

Magazinimi: hallka më e nënvlerësuar dhe më e rrezikshme

Pikërisht këtu, ku shpesh mendohet se puna është drejt fundit, humbja e cilësisë është më e lartë. Magazinat

e papërshtatshme, lagështia, temperatura e lartë dhe ekspozimi ndaj dritës mund të dëmtojnë seriozisht produktin.

Kushtet ideale të magazinimit përfshijnë:

- Lagështi 8–12%
- Temperaturë të freskët dhe konstante
- Ambient të errët dhe të ajrosur
- Paketim të papërshkueshëm nga lagështia
- Paletim të ngritur nga dyshemeja dhe larg mureve

Rreziqet kryesore janë myku, humbja e aromës, ndotjet dhe degradimi i ngjyrës. Nëse ndodhin, produkti shpesh humbet plotësisht vlerën tregtare.

Teknologjitë moderne: aleati i ri i fermerëve dhe eksportuesve

Ndërmarrjet shqiptare po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë për nevojën e modernizimit. Teknologji si:

- sensorët inteligjentë të lagështisë,
- kamerat AI për monitorimin e tharjes dhe magazinimit,
- sistemet e gjurmueshmërisë,
- pajisjet e kontrollit të temperaturës,

po përhapen gjithnjë e më shumë në sektor. Këto mjete ndihmojnë në ruajtjen e cilësisë, reduktimin e humbjeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare.

Për tregjet e BE-së, zbatimi i standardeve si GACP, GlobalG.A.P., HACCP dhe certifikimet organike nuk është më opsion. Është kusht për të hyrë në treg.

1. Sherebela (Salvia officinalis)

Shqipëria është ndër eksportueset më të mëdha të sherbelës drejt SHBA-së dhe BE-së. Sherebela është shumë e ndjeshme ndaj:

- Lagështisë** (rrezik i lartë për myk)
- Temperaturave të nxehta gjatë tharjes**
- Pluhurit dhe kontaminimit**

Momenti optimal i korrijes:

- Në maj–qershor, para lulëzimit.
- Në mëngjes, pasi është tharë vesa.

Temperatura e tharjes:

- 32–38°C.
- Mbi 40°C, vajrat esencialë fillojnë të degradojnë (humbje aromatike deri në 20%).

Humbja më e zakonshme:

- Nxirja e gjetheve kur tharja bëhet në temperatura të larta.
- Rritja e lagështisë në magazinë, që rrit rrezikun e mykut Aspergillus.

Standardet e BE-së për sherebelën:

- Papastërti ≤ 1%
- Lagështi ≤ 12%
- Ngjyrë homogjene gri–jeshile
- Pa fragmente të zeza dhe të djegura

2. Trumza (Thymus vulgaris / Thymus serpyllum) — një nga bimët më delikate

Trumza shqiptare është shumë e kërkuar në Gjermani, Francë dhe Zvicër për aromën e fortë.

Korrja:

- Në fillim të lulëzimit (qershor–korrik).
- Mos korni në orët e nxehtësisë — humbje e vajrave esencialë 30–40%.

Tharja:

- Temperatura optimale: 30–35°C.
- Kurrsesi > 38°C.

Rreziqet kryesore:

- Ngjitja e gjetheve për shkak të lagështisë së lartë.
- Humbja e aromës kur tharja bëhet shumë shpejt ose shumë ngadalë.

Paketimi:

- Në qese të papërshkueshme nga lagështia me valvul ajrimi.

3. Rigon (Origanum vulgare) — aromë që humbet lehtë

Rigonin e dëmton më shumë se çdo bimë tjetër nxehtësia

e tepruar.

Koha e korrijes:

- Kur janë hapur 50–70% e luleve (aroma maksimale).

Tharja:

- 28–32°C.
- Në ambiente shumë të ajrosura.

Rreziqet:

- Humbja e ngjyrës mund të jetë e menjëhershme në dritë të fortë.
- Rigoni shumë i shtypur humbet 25–35% të aromës.

4. Livando (Lavandula angustifolia) — kërkohet aromë e pastër dhe pa njolla

Shqipëria ka rritur fort kultivimin e livandos, por cilësia dëmtohet lehtë.

Korrja:

- Kur 70–80% e luleve janë hapur.

Tharja:

- 30–34°C.
- Nuk lejohet tharja direkt në diell.

Problemet më të shpeshta:

- Lagështia shkakton njolla kafe në lule.
- Në temperaturë të lartë, aroma “bëhet e rëndë”.

5. Çaj Mali (Sideritis spp.) — bima simbol e Shqipërisë

Eksportet e çajit të malit po rriten, por cilësia shpesh humbet gjatë magazinimit.

Korrja:

- Në fillim ose në mes të lulëzimit.
- Duhet shmangur korrja e pjesëve të drunjëzuara.

Tharja:

- 30–35°C.
- Bima duhet të jetë e shtrirë në shtresë të hollë.

Rreziku kryesor:

- Ngjyra bëhet e verdhë kur tharja është shumë e shpejtë.
- Aroma humbet kur lagështia në magazinë është mbi 60%.

Magazinimi: pika më kritike ku humb 30% e cilësisë

Magazinimi i MAPs kërkon kushte të monitoruara vazhdimisht:

- Lagështia:** 8–12%
- Temperatura:** e freskët dhe konstante
- Drita:** zero ekspozim
- Ajrosje:** e vazhdueshme
- Kontroll brejtësish dhe insektesh**
- Paletim i ngritur nga toka**

Nëse nuk ruhet korrektësia në këtë fazë, humbjet janë të menjëhershme:

- Ngjyra nxinet
- Aroma bie
- Rritet myku
- Cilësia perceptohet e ulët, çmimet bien

Cilësia — pasaporta e MAPs shqiptare drejt BE-së

Në një treg global ku konsumatorët dhe blerësit kërkojnë transparencë, siguri dhe cilësi të lartë, produktet shqiptare të MAPs kanë potencial të jashtëzakonshëm. Por ky potencial bëhet realitet vetëm kur zinxhiri i prodhimit funksionon si një sistem i plotë — i monitoruar, i kontrolluar dhe i standardizuar.

Ruajtja e cilësisë nga fusha në magazinë nuk është vetëm një detyrë teknike. Është një investim në të ardhmen e sektorit, në rritjen e të ardhurave të fermerëve dhe në pozicionimin e Shqipërisë si furnizues i besueshëm në tregun europian.

Nëse çdo hallkë e këtij zinxhiri përmirësohet, “Made in Albania” mund të kthehet pa diskutim në një markë cilësie për bimët aromatike dhe mjekësore — një treg ku konkurrenca është e madhe, por mundësitë janë edhe më të mëdha.



NJË INICIATIVË GLOBALE

GQSP ndihmon prodhuesit e vegjël për të përmirësuar cilësinë e produkteve të tyre, të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe të eksportojnë nëpër botë



UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Konteksti

Nga Industria Vendore drejt Tregut të BE-së – Cilësia është Çelësi

Rritja e konkurrueshmërisë së Shqipërisë dhe përgatitja e ndërmarrjeve për zhvillim të qëndrueshëm në tregun evropian dhe atë global janë në qendër të agjendës kombëtare të zhvillimit dhe integritit në BE. Ndërsa Shqipëria synon të diversifikojë eksportet, të rrisë prodhimin me vlerë të shtuar dhe të krijojë vende pune cilësore—veçanërisht në sektorë kyç si agrobiznesi, prodhimi dhe përpunimi ushqimor—aftësia e prodhuesve dhe NVM-ve për të përmbushur standardet ndërkombëtare bëhet një faktor përcaktues i suksesit.

Standardet dhe përputhshmëria nuk janë thjesht kërkesa teknike, por instrumente strategjike që mbështesin cilësinë, sigurinë dhe besueshmërinë në tregti. Ato i mundësojnë produkteve shqiptare të konkurrojnë në kushte të barabarta, të tërheqin investime dhe të hyjnë në Tregun Unik të BE-së, ku besimi i konsumatorit dhe përputhja me rregulloret janë thelbësore.

Forumi i 3-të Kombëtar për Cilësinë dhe Standardet, i organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe UBT dhe i mbajtur së bashku me Kongresin e 5-të të Këshillit Shqiptar të Agrobiznesit (KASH), dëshmon se pronësia e përbashkët dhe angazhimi i aktorëve janë thelbësore për të ruajtur progresin. UNIDO, KASH dhe partnerët kombëtarë po bashkojnë prodhuesit, shoqatat dhe institucionet për ta kthyer cilësinë në një motor të rritjes, konkurrueshmërisë dhe besueshmërisë për agrobiznesin shqiptar.

Ky event avancoi katër fusha prioritare që janë thelbësore për procesin e anëtarësimit në BE deri në vitin 2030:

- ▶ Bashkëpunimi dhe koordinimi mes aktorëve publikë dhe privatë;
- ▶ Mekanizimi, inovacioni dhe digitalizimi;
- ▶ Qasja e përmirësuar në financa dhe shpërndarja e efikase e granteve;
- ▶ Harmonizimi ligjor dhe nënligjor me legjislacionin e BE-së.

Forumi i përkthen këto prioritetë në masa praktike për përmirësimin e zinxhirit të vlerës, menaxhimin e cilësisë dhe sistemet e përputhshmërisë që i mundësojnë ndërmarrjeve të dëshmojnë integritetin e produktit nga burimi deri në treg.

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standardet (GQSP) të mbështetur nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO), luan një rol kyç në mbështetjen e këtyre përpjekjeve kombëtare. Asistenca teknike, udhëzimi politik dhe mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve nga UNIDO po ndihmojnë Shqipërinë të ndërtojë një sistem modern të Infrastrukturës së Cilësisë që i shërben drejtpërdrejt nevojave të ndërmarrjeve—duke i ndihmuar ato të arrijnë certifikimin, të sigurojnë gjurmueshmërinë dhe të përmbushin kërkesat rigoroze të konsumatorëve të BE-së.

Duke nxitur bashkëpunimin mes aktorëve publikë dhe privatë, promovuar digitalizimin dhe inovacionin, si dhe inkurajuar përputhshmërinë përmes iniciativave si GLOBALG.A.P., HACCP dhe certifikimi organik, UNIDO dhe KASH po sigurojnë që cilësia të jetë e integruar në çdo fazë të zinxhirit të vlerës. Kjo përpjekje kolektive e transformon përputhshmërinë nga një sfidë në një katalizator për suksesin në eksport, zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin e prodhuesve shqiptarë në Tregun Unik të BE-së.



Agjenda

FORUMI I 3-të KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE

► REGJISTRIMI
08:30 ● Regjistrimi, mirëseardhja dhe sesioni informues i hapjes

► HAPJA ZYRTARE E FORUMIT

09:00 – 09:50 ● Fjalët përshëndetëse

- Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës
- Z. Agim Rrapaj, Kryetar i KASH
- Znj. Elvana Zhezha, Koordinatore Kombëtare e UNIDO & GQSP në Shqipëri
- Sh.S. Znj. Ruth Huber, Ambasadore e Zvicrës në Shqipëri
- Sh.T.Z. Andis Salla, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Sh.S. Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër i Ekonomisë dhe Inovacionit (TBC)

► 09:50 – 10:10 ● PUSHIM KAFEJE

SEANCA PLENARE

► PANEL: NGA LOKALE NË GLOBALE – FORCIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË NVM-VE ME CILËSINË DHE STANDARDET E BE-SË

10.00 – 11:00 ● Folësit kryesorë

- Z. Dhimitër Kote, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Z. Sokol Duma, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
- Z. Ilir Ajdini, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
- Znj. Bruna Bello, Grupi Vendor i Veprimt (GVV) Berat
- Z. Filip Gjoka, Kryetar, Shoqata e Bimëve Mjekësore Aromatike
- Znj. Jetmira Kajoshi, Përfaqësuese nga “Shporta Nur Shkodër”

► 11:00 – 11:20 ● Pyetje dhe Përgjigje

► ÇELJA E KUVENDIT TË KASH

11:30 – 11:35 ● Mbërritja e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj

11:35 – 11:50 ● Raporti i KASH, Z. Agim Rrapaj, Kryetar KASH-it

11:50 – 12:00 ● Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Bajram Begaj, i drejtohet Kongresit të KASH

12.00 – 12:40 ● Folësit kryesorë

- Prof. Ethem Ruka, Universiteti “Luarasi”, Tiranë
- Prof. Sherif Lushaj, Universiteti “Polis”, Tiranë
- Prof. Jaho Cana, Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë
- Prof. Rexhep Uka, UKA Farm
- Prof. Entela Hoxhaj, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

► PANEL: KUVENDI KASH

12.40 – 13:10 ● Folësit kryesorë

- Z. Irfan Tarelli, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Z. Arben Shkodra, Shoqata e Prodhuesve Shqiptarë
- Z. Genti Beqiri, Programi Ndërkombëtar i Tregtisë, ITC
- Znj. Ines Muçostepa, Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
- Z. Luan Bregasi, Biznes Albania
- Z. Nagib Fejzi, Forumi Kombëtar Ekonomik
- Z. Perlat Sula, FED INVEST

► 13:10 – 14:00 ● NETWORKING DHE DREKË NË FORMË BUFETI

► 14:10 – 15:00 ● DISKUTIME DHE MIRATIM I RAPORTIT DHE REZOLUTËS SË PROJEKTIT

► 15:00 – 16:00 ● FJALËT PËRMBYLLËSE: REFLEKTIME DHE OBJEKTIVAT KRYESORE PËR T’U ARRITUR NË VITIN 2026





UNITED NATIONS
INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



KËSHILLI
AGROBIZNESIT
SHQIPTAR



UNIONI I DHOMAVE
TË TREGTISË DHE
INDUSTRIËS



UNIONI I DHOMAVE
TË TREGTISË DHE
INDUSTRIËS



GLOBAL QUALITY
AND STANDARDS PROGRAMME

FORUMI I 3-të KOMBËTAR I CILËSISË DHE STANDARDEVE

dhe KONGRESI i 5-të i KASH

Nga Industria Vendore drejt Tregut të BE-së • Cilësia është Çelësi

UNIDO dhe SECO në Mbështetje të Cilësisë, Përputhshmërisë dhe Konkurrueshmërisë

11
Nëntor

08.30
deri në 16.00

Universiteti
Bujqësor i
Tiranës

KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



BASHKËPUNIM

Thellohet partneriteti Shqipëri-Gjermani, fokusi tek bujqësia moderne dhe zhvillimi rural



Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, zhvilloi një takim me ambasadorin e Gjermanisë në Tiranë, Karl Bergner, si dhe me përfaqësues të lartë të bashkëpunimit ekonomik, Iven Schad dhe Mattia Wegmann (GIZ). Qëllimi i takimit ishte riafirmimi dhe thellimi i bashkëpunimit mes dy vendeve, me fokus të veçantë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë diskutimeve, u theksua rëndësia e partneritetit të

qëndrueshëm, i cili ka rezultuar në projekte konkrete në terren. Ministri Salla shprehu vlerësimin për mbështetjen afatgjatë të qeverisë gjermane, e cila realizohet kryesisht përmes projekteve të GIZ, asistencës teknike dhe ekspertizës.

Ky bashkëpunim është thelbësor në fusha kyçe si siguria ushqimore, inovacioni bujqësor dhe forcimi i kapaciteteve institucionale shqiptare.

Salla: Gjermania, “shtyllë thelbësore” për Shqipërinë 2030

Duke folur për rëndësinë strategjike të këtij partneriteti, Ministri Salla theksoi:

“Partneriteti me Gjermaninë mbetet një shtyllë thelbësore në rrugëtimin tonë drejt Shqipërisë 2030, me synimin për të zhvilluar një sektor bujqësor modern, të qëndrueshëm dhe konkurrues.”

Palët ndanë një qëndrim të përbashkët për të vijuar me

projekte që kanë dhënë tashmë rezultate pozitive. Gjithashtu, u diskutua për nisjen e projekteve të reja strategjike që do të kontribuojnë drejtpërdrejt në modernizimin e infrastrukturës bujqësore dhe në përgatitjet e Shqipërisë drejt integritetit evropian.

Takimi konfirmoi se të dyja palët janë të angazhuara për të sjellë inovacion dhe ekspertizë gjermane për zhvillimin e një sektori bujqësor më efikas në Shqipëri.

BE-ja dhe Suedia mbështesin sipërmarrjen dhe inovacionin në Shqipëri përmes EU4Innovation

Bashkimi Evropian, së bashku me Gjermaninë dhe Suedinë, po bashkëpunojnë me qeverinë shqiptare për të nxitur inovacionin dhe sipërmarrjen përmes programit EU4Innovation, një nismë që synon transformimin e Shqipërisë drejt një ekonomie të bazuar në dije dhe teknologji.

Ambasadori suedez Niklas Ström dhe Shefja e Bashkëpunimit të Delegacionit të BE-së, Ritva Heikkinen, vizituan bizneset e reja të ngritura nga fermerët e rinj në kuadër të programit, duke vlerësuar ndikimin e dukshëm të fondit të BE-së në zhvillimin lokal dhe krijimin e vendeve të reja pune.

Niklas Ström u shpreh se “Startup-et e mbështetura nga Challenge Fund në Divjakë, Dimal dhe Berat në fushën agro dhe të shërbimeve tregojnë se kanë pasur një impakt dhe zhvillim falë kësaj mbështetje. Suksesi i këtyre bizneseve tregon fuqinë e inovacionit dhe mbështetjen e qëndrueshme për komunitetet lokale”.

Ndërsa Ritva Heikkinen deklaroi se “Është kënaqësi të shohësh idetë e sipërmarrësve të shndërrohen në biznese të lulëzuara dhe mundësi të reja për të rinjtë. Inovacioni është çelësi për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë shqiptare. Përmes këtij programi forcojmë ekosistemin e inovacionit, ofrojmë financime të ndryshme për bizneset dhe



inkurajojmë bashkëpunimin midis universiteteve, bizneseve dhe qeverisë”.

“Shqipëria është plot me sipërmarrës dhe ka një frymë të vërtetë sipërmarrëse. BE-ja do të vazhdojë të mbështesë inovatorët e Shqipërisë. Ne duhet të bashkojmë forcat për të ndërtuar një ekonomi inovacioni dhe rritjeje të qëndrueshme që sjell vende të reja pune dhe më të mira për qytetarët e Shqipërisë”, tha përfaqësuesja e Bashkimit Evropian Ritva Heikkinen.

Gjatë vizitës në kuadër të programit EU4Innovation, ambasadori Ström dhe përfaqësuesja e BE-së Heikkinen e vlerësuan pozitivisht punën e disa bizneseve të reja shqiptare që po sjellin modele inovative dhe të qëndrueshme zhvillimi.

Një nga bizneset e sukseshme që ka mbështetur programi është Biolive, një sipërmarrje e themeluar në 2023 në Divjakë, që prodhon vaj ulliri ekstra të virgjër dhe tashmë eksporton në Zvicër, Holandë dhe Dubai, duke punuar me mbi 600 fermerë shqiptarë. Përveç Biolive, u vlerësua edhe puna e “Rinora Handmade”, që kultivon sfungjerë natyralë “loofah” me model prodhimi të ciklit të mbyllur.

Ndër to, Sugo.al shquhet për prodhimin e salcës së domates natyrale pa aditivë kimikë, duke u fokusuar në cilësi dhe në zgjidhje të gjelbra për sektorin HORECA. Ndërsa Crystal Team, një biznes me ndikim social në Berat, ofron shërbime pastrimi, kopshtarie dhe kujdesi për të moshuarit, duke fuqi-

zuar ekonomkisht nënat nga komunitetet rome dhe zonat e marginalizuara.

“Rinora Handmade” Startup-i shqiptar që kultivon sfungjerë natyralë dhe sfidon tregjet ndërkombëtare

Në fushat e Dimalit, një startup familjar po sjell një inovacion të rrallë në bujqësinë shqiptare. “Rinora Handmade”, i drejtuar nga Rakipi, kultivon luffa – sfungjerin natyral që përdoret për kujdesin e trupit dhe pastrimin ekologjik të shtëpisë duke u bërë i pari në Shqipëri dhe i dyti në Europë që ndjek një model prodhimi me cikël të mbyllur ekologjik.

“Pasi është vjelë luffa në fushë, bëhet larja paraprake, thahet dhe më pas i nënshtrohet një larjeje përfundimtare me presion të lartë 200 gradë.

Ndryshe nga perimet apo frutat e tjerë, puna me luffën filon pas vjeljes. Pas heqjes së saponinës, produkti pastrohet plotësisht dhe më pas pritët sipas formave të ndryshme nga sfungjerë cilindrikë për trupin te format e personalizuara për banjën apo kuzhinën”, tregon Rakipi.

Ai shpjegon se ky është një proces që kërkon përkushtim gjatë gjithë vitit, nga janari në dhjetor, dhe se sfidat kryesore mbeten tregu dhe mungesa e fuqisë punëtore.

“Tregu është i vështirë, nuk e njohin të gjithë produktin. Kryesisht shesim online dhe kemi kërkesa për eksport, por synojmë që konsumatori shqiptar të jetë përfituesi kryesor. Nuk kemi qëllim vetëm fitimin – duam të promovojmë një produkt natyral shqiptar”.

Përveç cilësisë së lartë të fibrës së luffës shqiptare, Rakipi thekson edhe aspektin ekologjik të punës së tyre.

“Luffa që kemi në Shqipëri, pa modesti, është më e mira në botë. Kemi krijuar një proces që nis me fermentimin për ta zbardhur, dhe përdorim një cikël ekologjik për produktet tona. Vadijtjen dikur e bënim me naftë, tani kemi investuar për ta bërë me energji elektrike. Edhe plastmasin që përdorim për mbrojtjen e ujit e kemi sjellë nga Kosova, pasi është i biodegradueshëm”, tha ai.

“Rinora Handmade” është

një biznes familjar, ku punojnë kryesisht gratë e zonës.

E lindur nga një përvojë pune në Vietnam, mbështetur nga EU4Innovation ideja e luffës shqiptare është shndërruar në një shembull frymëzues se si inovacioni, përkushtimi dhe ekologjia mund të bashkohen në një produkt “Made in Albania” që po ngjall interes edhe në tregjet ndërkombëtare.

Programi EU4Innovation, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida), dhe i zbatuar nga GIZ Shqipëri dhe Ambasada Suedeze në Tiranë, ka një fond prej 10 milionë eurosh për startup-et dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Duke ofruar financime të ndryshme, ai synon të krijojë një ekosistem të qëndrueshëm inovacioni dhe të pozicionojë Shqipërinë si një qendër rajonale për ide të reja, sipërmarrje dhe bashkëpunim ndërkombëtar në teknologji.

Challenge Fund, si një komponent kyç i programit, i zbatuar në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, me një fond prej 1 milion euro, ka mbështetur 56 startup-e fituese nga 637 aplikime, nga 43 qytete dhe 22 sektorë të ndryshëm.



Hapat që ndiqen për kalimin e fermës, nga fermë e zakonshme në fermë biologjike/organike



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

(Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike)

Tetor, 2024

*Këtë shkrim e ofrojmë për të gjithë të interesuarit, të cilët kanë paqartësi për këto hapa, e sidomos për fermerët e rinj, të cilët kanë prirje të përkrahin këtë sistem bujqësie me të ardhme. Me këto njohuri fillestare keni mundësi të thelloheni më tej për të qartësuar pyetjet e tjera që ju dalin në punë e sipër rreth kësaj teme. Jeni të lirë të pyesni autorin e këtij shkrimi me adresën: **en.isufi@gmail.com** ose me **telefon** dhe **WhatsApp**, me numër **(069 5678 857)***

Si tashmë është e ditur, sistemi i bujqësisë biologjike/organike (janë terma të barazvlefshëm, por më pranë së vërtetës është termi “biologjik”). Kjo sepse ky term lidh teknologjinë me cilësinë e produktit. Termi “bio” do të thotë që produkti është më jetësor, më natyral (Bio = jetë). Këtë e vërteton fakti që ky sistem bujqësie funksionon me ligje që miratohen në parlamentet e secilit vend.

Për këtë arsye ka disa kritere që duhen zbatuar, të cilat ndiqen në mënyrë logjike, siç paraqiten të përshkruara më poshtë.

Hapi parë	Fermeri drejton kërkesën në Zyrën e Bujqësisë të zonës përkatëse ku shpreh dëshirën për ta kthyer fermën nga fermë e zakonshme në fermë biologjike.
Hapi dytë	Eksperti i Zyrës së Bujqësisë të zonës vjen në fermën përkatëse dhe bën analizën e rrezikut. Ka një kriter me 10 pika i cili ndihmon në vlerësimin e mundësisë ose jo të risqeve. Nëse ferma rezulton se nuk ka shkaqe rreziku, ajo regjistrohet si fermë e cila mund të fillojë teknikat e bujqësisë biologjike. Nga këtu kalohet në hapin e tretë.
Hapi tretë	Fermeri i nënshtrohet kurseve të trajnimeve dhe demonstrimeve fushore për të përvetësuar standardin e prodhimit bio/organik. Ai duhet të përdorë ato inpute (plehra, produkte të mbrojtjes së bimëve, farëra), të cilat lejohen të përdoren në prodhimin biologjik dhe që janë të listuara në
Hapi katërt	Brenda periudhës bimore, gjithmonë para vjeljeve vjen inspektori të kontrollojë të gjitha hapat e prodhimit, nëse është zbatuar standardi ose jo. Inspektori ka tabelën me pyetësorin, me të cilën e kontrollojnë në detaje njësinë e prodhimit.
Hapi pestë	Dokumentet e inspektimit fushorë, inspektori ja kalon personit të certifikimit, i cili është brenda "Trupës së Certifikimit". Kur kontrollojnë dokumentacionin e sjellë nga inspektori, nëse personi i certifikimit nuk shikon shkelje të standardit nga fermeri, ai lëshon certifikatën. Certifika sipas
	- Bio në kalim viti i parë
	- Bio në kalim viti i dytë
	- Bio e plotë viti i tretë (plotësisht bio)
Hapi gjashtë	Fermeri merr certifikatën, e cila vërteton se ai ka të drejtë ta nxjerrë produktin në treg me logon Bio, pra "produkt biologjik"
	Gjithashtu fermeri me këtë certifikatë fiton subvencionin sipas statusit të fermës. Pra ndërsa në treg fermeri del në vitin e tretë, subvencionin (ndihmën financiare) e merr që në vitin e parë kur është regjistruar si fermë «bio në kalim»

Pyetjet më të shpeshta që drejtohen nga të intresuarit mbi këtë interesim janë këta si më poshtë:

Pyetje: A ka kërkesa paraprake në lidhje me fermën e mëparshme konvencionale në momentin që ferma regjistrohet për të kaluar në fermë biologjike?

Përgjigje: Jo. Ferma le të ketë qenë konvencionale, por nga momenti që regjistrohet si fermë bio në kalim viti i parë, fillon teknologjinë e bujqësisë biologjike, e cila përputhet me standardin përkatës.

Pyetje: Po nëse toka që do fillojë prodhimin bio ka shumë vite pa u punuar, ose nuk është plehëruar dhe spërkatur, e regjistrohet direkt si fermë biologjike?

Përgjigje: Po. por jo direkt si ferma biologjike, por fiton një vit, pra nuk duhen tre vjet për të kaluar në fermë bio, por vetëm dy vjet.

Kur kjo tokë ka vite pa u përdorur, duhet që pronari të lëshojë një deklaratë që toka nuk është përdorur. Do ishte mirë që këtë ta dëshmonte edhe një specialist i zonës. Po e pa të arsyeshme trupa e certifikimit merr një mostër toke për t’u bindur se nuk ka mbetje kimike si plehra kimike ose mbetje pesticidesh.

Pyetje: Cila është trupa kryesore e certifikimit në Shqipëri?

Përgjigje: Trupa certifikimit, e cila e regjistruar në vitin 2006, më parë quhej “ALBINS-PEKT”. Vitet e fundit ajo është e bashkuar me trupën e certifikimit më të madhe zvicerane e quajtur “Bioinspekta” dhe tani kjo trupë certifikimi ka emrin pikërisht “Bioinspekta”. Kjo trupe me seli në Tiranë, ka statusin të certifikojë edhe në Kosovë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Kjo cerifikatë njihet edhe për produktet bio që eksportohen në vendet jashtë Shqipërisë, sepse kjo trupë certifikimi është e akredituar dhe është në listën evropiane të trupave të certifikimit.

Më poshtë po ju ofrojmë edhe adresën e trupës së certifikimit “Bioinspekta”

bio.inspecta shpk, Rruga e Kavajës, Ndërtesa 132 Hy. 9, Ap. 43, 1023 Tirana, Albanien
Tel + 355 44806018 (contact@bio-inspecta.al)

Fermeri ka të drejtë të negociojë çmimet e shërbimit të certifikimit. Pasi bie dakord me trupën e certifikimit ai bën një kontratë paraprake me trupën e certifikimit, ku angazhohen se do të punojnë së bashku konform pagesave të dakordësuara në kontratë.

Pyetje: Si janë kuotat e mbështetjes financiare nga shteti për fermat biologjike?

Përgjigje:

- Fermat që dorëzojnë certifikatën Bio në kalim viti parë, marrin **100 mijë Lekë**
- Fermat në kalim viti i dytë, marrin **150 mijë Lekë**
- Fermat bio e plotë, pra në vitin e tretë marrin **200 mijë Lekë**.

Pyetje: A shiten si produkte bio produktet me statusin “Bio në kalim”?

Përgjigje: Jo. Si produkt bio shitet vetëm produkti që ka certifikatën “Bio i plotë”

Pyetje: Nëse fermeri nuk bie dakord me vlerësimin e inspektorit, çfarë ndodh?

Përgjigje: Trupat e certifikimit kanë një organizëm të pavarur ankimimi.

Ky komision shqyrton vrejttet e fermerit dhe nëse e gjykon se inspektori ka qenë më strikt se sa duhet, merr vendimin që ai të fitojë të drejtën e certifikimit.

FERMA BIOLOGJIKE

HAPAT NGA REGJISTRIMI DERI NË ÇERTIFIKIM



Fermeri bën kërkesë për ta kthyer fermën e tij në fermë biologjike. (Te zyrat e bujqësisë, shoqata përkatëse, instituti i bujqësisë biologjike.)



Eksperti i bujqësisë biologjike duke iu përgjigjur kërkesës së fermerit vjen dhe bën analizën e rrezikut.

Ka një kriter me 10 pika që vendos nëse mundet kjo fermë të kalojë në bio ose jo. Nëse fermës i besohet , kolohet në hapin e tretë.



Fermeri i nënshtrohet kurseve të trajnimeve dhe demonstrimeve fushore për të përvetësuar standartin e prodhimit bio.

Ai duhet të përdorë ato inpute që lejohen, si dhe të respektojë edhe pika të tjera të standarteve si: higjiena e mjesidisit, e ujit, e tokës,



Brënda periudhës bimore, gjithmonë para vjeljeve vjen inspektori i trupës së certifikimit i cili kontrollojnë të gjitha hapat e prodhimit, nëse është zbatuar standarti apo jo.



Dokumentat e kontrollit fushor i shikon certifikuesi. Nëse ai në dokumentat e inspektimit fushor nuk shikon shkelje të standartit nga fermeri atëherë ai lëshon certifikatën e prodhimit. Kjo certifikatë mund të jetë: K1 ose K2 ose Bio (K1- Kalim viti i parë, K2 - Kalim viti i dytë. Vitin e tretë certifikata lëshohet si produkt Bio i plotë.)



Fermeri mer certifikatën që verteton se ai ka të drejtë ta nxjerrë në treg produktin me logon Bio i plotë.

KËNDI I EKSPERTIT

Hapat që ndiqen për kalimin e fermës, nga fermë e zakonshme në fermë biologjike/organike

(Vijon nga faqja 11)

PESË AKTORËT KRYESORË NË ÇDO BIZNES				
				
Prodhuesi	Trajnuesi	Çertifikuesi	Marketingu	Konsumatori
Prodhon shumëllojshmëri produktesh. Ai ka një objektiv të përhershëm: Të prodhojë shumë dhe të fitojë shumë.	Edukon prodhuesit nga ana profesionale që ata të arrijnë të prodhojnë shumë dhe mirë.	Kontrollon të gjitha hallkat e prodhimit, përpunimit, paketimit e tregtimit që të jenë në përputhje me standartet përkatëse.	Studion tregun, zbulon mallrat e mira, gjen klientët dhe kërkesat e tyre.	Është secili prej nesh. Motoja e tij është të blejë shumë, lirë dhe mirë.

(E. Isufi)

Sipërmarrja e gjelbër: Bio-Waste Innovation Challenge prezanton 11 ide innovative për trajtimin e mbetjeve bio

(Vijon nga faqja 6)

serrë. Zgjidhjet inovative janë thelbësore për tranzicionin e gjelbër të Shqipërisë dhe për përmbushjen e standardeve mjedisore të BE-së, vlerësuan përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së në Shqipëri dhe Ambasadës Gjermane, Bio-Waste Innovation Challenge zhvillohet në kuadër të projektit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme” – i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), dhe zbatohet nga GIZ Albania në partneritet me Ministrinë e Mjedisit dhe synon të nxisë krijimin e tregjeve të reja për trajtimin e mbetjeve organike dhe zhvillimin e produkteve të gjelbra. Kjo qasje kontribuon në reduktimin e mbetjeve të patrajtuara dhe mbështet përmbushjen e standardeve mjedisore të Bashkimit Evropian.



(Vijon nga numri 519)

Ndërtesa Skënderbeu në Tiranë

Ndërtesa Skënderbeu 85 metra e lartë, e njohur zyrtarisht si Shkëmbi i Tiranës. Studio holandeze MVRDV ka nisur

time që i bëjnë jehonë hundës, veshëve dhe mjekrës. "Efekti që rezulton është disi delikat;




ndërtimin e një godine me përdorime të përziera në Tiranë, Shqipëri, të cilën e ka modeluar sipas një busti të figurës së shquar historike të vendit Gjergj Kastrioti. Ndërtesa Skënderbeu 85 metra e lartë, e njohur zyrtarisht si Shkëmbi i Tiranës, u projektua nga MVRDV për t'u dyfishuar si "një skulpturë figurative" e Kastriotit.

"Këto ditë, qytetet në mbarë botën ngajjnë gjithnjë e më shumë me njëri-tjetrin, unë gjithmonë i inkurajoj që t'i rezistojnë kësaj, të gjejnë karakterin e tyre individual dhe ta theksojnë atë", thotë partneri themelues i MVRDV, Winy Maas. "Për mua, ndërtesa Skënderbeu është një mundësi për të bërë pikërisht këtë. Ajo sjell kuptim të ri në elementët ekzistues të arkitekturës shqiptare."

Ndërtesa Skënderbeu është në ndërtim e sipër në një "vend me formë të sikletshme" në këndin verilindor të sheshit, të cilin ajo është projektuar për ta mbushur. "Shpatullat e tij përputhen me pjesën më të gjerë të vendit, ndërsa koka e tij është e kthyer djathtas, përballë sheshit që mban emrin e tij", shpjegoi MVRDV. Pasi të përfundojë, ai do të përbajë një nivel të hapësirës tregtare dhe katër nivele zyrash në pjesën më të gjerë të godinës që i ngjan shpatullave të Kastriotit. Mbi këtë do të jenë 20 kate apartamente banimi, që zënë pjesën e sipërme të palatit që është modeluar në kokën e tij. Pamja delikate si kokë e ndërtesës arrihet kryesisht me ballkone të lakuar në çdo nivel. Secila prej tyre është skalitur nga MVRDV me një formë unike, duke krijuar zgja-

Pylli Vertikal: Ndërtesa 117 metra e lartë në Lausanne, Zvicër

"Arkitekti italian Stefano Boeri ka zgjedhur për të ndërtuar këtë rezidencë në Zvicër, e cila do të jetë shtëpia e mbi 100 pemëve. Një ndërtesë tejet



Pylli vertikal: Lausanne, Zvicër

e gjelbëruar.

Projekti i Kullës së Kedrave

KËNDI I EKSPERTIT

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari dhe Planifikues Urban Ema Meçollari

nga Stefano Boeri Architetti filloi në vitin 2015 si pjesë e planit për të rindërtuar lagjen 'Les Cèdres'.

Projekti synon të krijojë një gjendje unike shkëmbimi dhe empatie me peizazhin tipik lokal të liqenit, duke u hapur plotësisht drejt Liqenit të Gjenevës. Një prani që konfirmon dhe përforcon ekuilibrin e jashtëzakonshëm që ekziston midis natyrës dhe qytetit, sipërfaqes së ujit, pyllit dhe fushave: elementët bazë që përbëjnë ADN-në e peizazhit Chavannes. Në këto terma, projekti mund të lexohet si një "simbol i gjallë" i një marrëdhënieje të re midis sferës urbane dhe sferës natyrore: një episod themelor i arkitekturës së biodiversitetit, një zhvillim i konceptit të pyllëzimit vertikal që po sheh dritën për herë të parë edhe në Zvicër.

Një ndërtesë kryesisht bane-sore. Kulla e Kedrave ka një plan drejtkëndor dyshemeje dhe një lartësi prej 117 metrash (36 kate). Në përputhje me filozofinë e projektimit të Pyjeve Vertikale, Kulla e Kedrave akomodon 152 pemë të mëdha, shkurre dhe bimë të tjera të prerjeve dhe specieve të ndryshme, të përzgjedhura nga esenca vendase, për një sipërfaqe totale mbjelljeje prej afërsisht 1,293 metrash katrorë, duke rifilluar dhe vendosur një dialog dhe vazhdimësi të habitatit me speciet që tashmë popullojnë zonën përreth. Një ftesë për të jetuar dhe bashkëjetuar në harmoni me natyrën, për të ndarë me banorët e tjerë një përvojë të pazakontë afërsie me pemët, bimët dhe zogjtë e qiellit të Chavannes.

Përveç 252 apartamenteve me madhësi dhe artikulum shpërndarjeje të ndryshme, Kulla e Kedrave gjithashtu akomodon aktivitete me interes publik në dy katet e para dhe në katin e 32-të.

Së fundmi, projekti përmban 331 panele fotovoltaike në çati, për një sipërfaqe totale prej 688 metrash katrorë, me kapacitet për të prodhuar me kapacitet të plotë, 128 KWh/vit energji elektrike. Të kombinuara me një central gjeotermal, këto zgjidhje sigurojnë që nevojat e kullës për energji të mbulohen në një mënyrë të qëndrueshme, duke shtuar përfitimet natyrore të ofruara nga prania e gjelbërimit në fasadë - siç janë hija, thithja e CO2 dhe pluhurit të imët, prodhimi i oksigjenit dhe krijimi i një mikroklimë më të banueshme për përdoruesit - dhe e bëjnë projektin e Kullës së Kedrave një pikë referimi unike dhe dalluese.

Pylli vertikal i Tiranës (Tirana vertical forest)

Projektuar nga Stefano Boeri Architetti, Pylli i parë vertikal i Tiranës qëndron në qendër të qytetit, pranë Parkut të Madh të kryeqytetit shqiptar

(Parku i Madh i Tiranës).

Ndërtesa e re, "hapet si një lule" drejt qytetit përmes tre



anëve të mbetura (njëra anë mbështetet në një ndërtesë tjetër aty afër), të cilat strehojnë 3200 bimë dhe shkurre së bashku me 145 pemë.

Me dritaret e tyre me lartësi të plotë, fasadat plotësisht me xham lejojnë që marrëdhënia midis bimësisë dhe pamjeve të qytetit të maksimizohet plotësisht, ndërsa lejon vëzhguesit të vlerësojnë bukurinë e masës bimëre që do të ketë një efekt të konsiderueshëm lehtësues në ndotjen e ajrit.

Thithja e CO2 dhe grimcave të imëta nga bimët e vendosura në të tre anët është e kombinuar me oksigjenin që prodhojnë për të krijuar një mikroklimë mjaft të shëndetshme. Duke qenë e vendosur në një nga kryeqytetet mesdhetare, Pylli Vertikal i Tiranës do të jetë shtëpia e bimëve dhe pemëve tipike specifike të zgjedhura nga botanistja dhe arkitektja e peizazhit Laura Gatti të cilat lidhen me ekosistemin specifik.

Këto përfshijnë kaçube me ngjyra të gjalla dhe lule të ndritshme, si dhe bimë me aromë rozmarinë. Ndërhyrja është konceptuar si Pylli i Parë Vertikal i Shqipërisë në përputhje me Masterplanin e ri 2016, një element themelor i të cilit është përmbajtja e konsiderueshme e përdorimit të tokës në zonën metropolitane dhe një rritje e konsiderueshme e sipërfaqeve të gjelbërta dhe të pyllëzuara, si brenda dhe përreth qytetit.

Ndërtesa është e vendosur në qendër të qytetit pranë Sheshit "Nënë Tereza", një nga pikat përfundimtare të Bulevardit historik "Dëshmorët e Kombit", dhe shfaqet në kontekstin urban si një referencë natyrore për bimësinë mesdhetare tipike të zonës gjeografike lokale. Ndërhyrja konsiston në një element vertikal arkitektonik me 4 kate në nivelin e tokës, një kat përdhës kryesisht tregtar / me pakicë dhe 21 kate mbi të cilat do të strehohen 105 apartamente.

Projekti mishëron konceptin e Pyllit Urban progresive për qytetet dhe metropolet në të gjithë botën, dhe është bartësi standard i një strategjie dhe imazhi për një koncept që hapet drejt qytetit dhe hapësirave

përreth.

Ky projekt është i ngjashëm me projektin Pylli Vertikal: Ndërtesa 117 metra e lartë në Lausanne, Zvicër dhe për faktin se është projektura nga i njëjti autor.

Mali i Tiranës, projekti i një kulle të lartë në Shqipëri

"Nova Construction" do të jetë kompania që do ndërtojë kullën më të re të Tiranës pas



Teatrit të Operas dhe Baletit. Leja për kullën që do të quhet "Mali i Tiranës" është dhënë nga Erion Veliaj dhe projektues i saj u zgjodh sot në një konkurs, kompania daneze Cebra.

Pas përfundimit të saj, kulla e shkallëzuar "Mali i Tiranës" do të vendoset në zemër të qytetit.

CEBRA u shpall fitues i konkursit të projektit nga një juri ndërkombëtare.

Përmbledhja kërkonte projektimin e një kulle shumëfunktionale që ngrihet 185 metra, që do të bëhet një pikë referimi e re urbane për kryeqytetin. Mali i Tiranës pritet të bëhet ndërtesa më e lartë në Shqipëri,



me arkitekturën e tij të veçantë nga CEBRA.

Arkitektët u frymëzuan nga vargmali i Skënderbeut që rrethon kryeqytetin, duke përsëritur shkëmbinjtë e thyer dhe bimësinë e formave natyrore të tokës.

Vëllimi i përgjithshëm sugjeron një faqe shkëmbi të prerë, ndërsa fasada është e veshur me sipërfaqe guri të zhveshur. Me Malin e Tiranës, CEBRA prezanton një mori programesh shumëfunktionale në kryeqytet.

"Malet janë një nga karakteristikat më mbresëlënëse

të natyrës. Të përzetshme, të mahnitshme dhe të bukura, ato janë pika referimi origjinale. Duke përdorur malet e Shqipërisë si burim tonë kryesor të frymëzimit, ne prekim historinë lokale, trashëgiminë kulturore dhe identitetin e Shqipërisë", "Kjo pikë referimi simbolike do të krijojë një lidhje elegante midis strukturës urbane gjithnjë në transformim të Tiranës dhe mjedisit natyror - një hibrid arkitektonik midis një kulle dhe një mali dhe një tipologjie ndërkom-bëtare, e cila është e ankoruar në vend," thotë Mikkel Frost, Partner Themelues dhe Arkitekt në CEBRA.

Kjo përfshin strehimin, shitjen me pakicë, një hotel butik, një zonë biznesi, zyra dhe ambiente parkimi, si dhe restorante dhe kafene.

Ekipi synon të minimizojë gjurmën e karbonit të ndërtesës, duke ankoruar dizajnin narrativ. Arkitektët shpjegojnë: "Mali i Tiranës do të ndërtohet kryesisht nga materiale vendase si guri natyror. Përveç kësaj, janë bërë përpjekje për të minimizuar nevojën e ndërtesave për ftohje mekanike dhe për të zgjedhur bimë autoktone për tarracat, të cilat do të mbështesin gjithashtu biodiversitetin e zonës.

Titulli i projektit: Mali i Tiranës. Studio e arkitekturës: CEBRA architecture. Klienti: Nova Construction 2012. Sipërfaqja e ndërtimit: 70.000 metra katrorë. Lartësia: 185 metra.

Syri i Tiranës (Eye of Tirana)

Eye of Tirana ndodhet në qendër të kryeqytetit dhe është një nga projektet më ambicioze të Masterplanit për Tiranën. Projektimi është vepër e një prej studiove më të mëdha daneze dhe është konceptuar sipas stilit të arkitektit Henning Larsen, me qëllim që të

theksojë stilin arkitektural të qytetit. Maja e kullës, që hapet si lule, sfidon gravitetin. Atriumet kanë pamjen e një syri nga ka marrë dhe këtë emër.

Eye of Tirana është projektuar si një ndërtesë e madhe, 26 kate e lartë për të zhvilluar profilin e kryeqytetit shqiptar. Propozimi përbëhet nga tre pjesë të godinës që do të pëmbajnë artamente, zyra dhe dyqane që arrijnë në total në 63.500 m2.

Propozimi i projektit është bazuar në zgjidhje të qëndrueshme

(Vijon në faqen 14)

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga faqja 13)


Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban

me fokus ventilim natyror, energjinë diellore dhe masave të tjera të kursimit të energjisë. Projekti fitoi çmimin e parë për idenë e tij të përgjithshme të integritetit të jetës urbane me funksionet e ndërtesës, duke shtuar se cilësitë dhe mundësitë e Tiranës që kanë dispozicion sot.

Kulla “Syri i Tiranës”. Ajo po ngrihet në hapësirën mes rrugës së Durrësit dhe Rrugës së Kavajës, në rrëzë të sheshit “Skënderbej”. Ajo sipas projektit duhet të ishte 26 kate por gjatë procesit të ndërtimit ka shkuar në mbi 32 kate.

Dekripëzimi pa shkatërrim mjedisi – Teatri Ujor i Las Palmas

Në shekullin aktual, për shkak të ngrohjes globale, ndotjes, ndryshimeve klimatike dhe rritjes eksponenciale të popullsisë botërore, burimet ujore konsumohen me ritme alarmante. Për këtë arsye, metodat e qëndrueshme të mbled-



hjes së ujit janë bërë një temë e rëndësishme kërkimore e sotme.

Në Ishujt Kanarie, ku uji i ëmbël është një burim i rrallë, Teatri i Ujit në Las Palmas shfaq një qasje pioniere ndaj dekripëzimit që kombinon qëndrueshmërinë, artin dhe teknologjinë më të përparuar. I frymëzuar nga mjedisi natyror i rajonit dhe nevoja për furnizim efikas me ujë, ky projekt inovativ eksploron dekripëzimin pa dëmtimin mjedisor, duke siguruar që nga procesi të përfitojnë si komunitetin lokal ashtu edhe ekosistemi.

Për këtë arkitektët në Grimshaw iu drejtuan një krijese tjetër për frymëzim, e cila është në të njëjtën situatë. Brumbulli i shkretëtirës namibiane i specializuar në mbledhjen e ujit nga ajri duke u rreshtuar në drejtimin e rrjedhës së ajrit dhe duke kondensuar mjegullën në ekzoskeletonin e tij, një kombinim i sipërfaqeve hidrofile dhe hidrofobike. Duke imituar aftësitë e tij, fasada e impiantit të dekripëzimit është orientuar përgjatë boshtit të erës dhe është pajisur me kondensatorë qelqi të projektuar në mënyrë të ngjashme që funksionojnë me ujë deti të ftohtë të transportuar nga 1000 m nën nivelin e detit. Avulluesit furnizohen me energji nga energjia

diellore dhe i gjithë montimi formon një sfond për një amfiteatër. Një qasje e ngjashme për mbledhjen e ujit atmosferik është zbatuar në Qendrën e Hidrologjisë së Universitetit të Namibisë.

Projekti përdor energjinë diellore për të furnizuar me energji impiantet e shkripëzimit, duke zvogëluar gjurmën e karbonit të procesit të prodhimit të ujit. Duke shfrytëzuar energjinë e rinovueshme, sistemi përputhet me përpjekjet globale për të zvogëluar varësinë nga lëndët djegëse fosile.

Sistemi i shkripëzimit në Teatrin e Ujit në Las Palmas mbështetet në biomimetikë për të përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë. Ashtu si organizmat detarë filtrojnë ujin e detit për të nxjerrë lëndët ushqyese të nevojshme, sistemi imiton këto mekanizma biologjikë të filtrimit për të përmirësuar shkripëzimin.



Përtej ndikimit të tij teknologjik dhe mjedisor, Teatri Ujor i Las Palmas është

mjegull dhe vesë në shpinë, në kundërshtim me besimet e mëparshme. ...

Teatri Ujor i Las Palmas përfshin teknologji të përparuar të shkripëzimit që minimizon këtë ndikim mjedisor. Zbatimet: Shkripëzimi me efikasitet energjetik: Projekti përdor energjinë diellore për të furnizuar me energji impiantet e shkripëzimit, duke zvogëluar gjurmën e karbonit të procesit të prodhimit të ujit. Inovacioni kursen 10 herë energjinë e përdorur për prodhimin e ujërave të ëmbla.

Pallati i vogël i sportit në Romë

Dizenuar sipas Victoria Amazonica: Zambaku Gjigant i Ujit. Victoria Amazonica, e njohur edhe si zambaku i ujit Victoria, është një bimë ujore e jashtëzakonshme vendase në Guajana dhe Amerikën tropikale të Jugut. E festuar si



lulja kombëtare e Guajanës, kjo bimë është e famshme për gjethet e saj të mëdha rrethore, të cilat mund të rriten deri në 3 metra të gjera.



Shumë e vlerësuar si një bimë zbukuruese për bukurinë dhe veçantinë e saj, farat e saj janë gjithashtu të ngrënshme dhe mund të pihen. Interesante është se gjethet mbresëlënëse

të kësaj bime frymëzuan projektin e Joseph Paxton për Pallatin e Kristalit në 1851.

Pavarësisht kërkesave specifike të habitatit, Victoria Amazonica aktualisht nuk konsiderohet një specie e kërcënuar, duke e bërë atë një mrekulli të lulëzuar të botës natyrore.


Pallati i Kristalit ishte një strukturë prej gize dhe qelqi të pllakëzuar, e ndërtuar fillimisht në Hyde Park, Londër, për të strehuar Ekspozitën e Madhe të vitit 1851. Ekspozita u zhvillua nga 1 maji deri më 15 tetor 1851, dhe më shumë se 14,000 ekspozues nga e gjithë bota u mblodhën në hapësirën e saj të ekspozitës prej 92,000 m² për të shfaqur shembuj të teknologjisë së zhvilluar në Revolucionin Industrial. E projektuar nga Joseph Paxton, ndërtesa e Ekspozitës së Madhe ishte 564 m e gjatë, me një lartësi të brendshme prej 39 m, dhe ishte tre herë më e madhe se Katedrala e Shën Palit.

293,000 panelet e qelqit u prodhuan nga Vëllezërit Chance. Ndërtesa prej 990,000 metrash katrorë me tavanin e saj prej 128 metrash të lartë u përfundua në tridhjetë e nëntë javë. Pallati i Kristalit krenohej me sipërfaqen më të madhe të qelqit të parë ndonjëherë në një ndërtesë. I mahnit vizitorët me muret dhe tavanet e saj të qarta që nuk kishin nevojë për ndriçim të brendshëm.

Stadiumi Kombëtar i Pekinit, Kinë

Stadiumi Kombëtar i Pekinit, i njohur gjerësisht si “Foleja e zogut”, u projektua nga arkitektët zviceranë Herzog & de Meuron në vitin 2008. Forma rrethore e stadiumit Olimpik të Pekinit përfaqëson parajsën, por është përshkruar si një fole zogjsh. Ai shfaq biomimetikën në dizajn përmes një pamjeje të jashtme që përmban veshje çeliku të ndërlikuar, duke marrë një formë të ngjashme me foletë e zogjve. Përveç estetikës, dizajni përdor panele etilen tetrafluoroetileni (ETFE) të mbushura midis boshllëqeve të çelikut, duke ofruar strehim nga elementët

Stadiumi u projektua për të simbolizuar 'natyrën e madhe' në tokë, me një temë të përgjith-



shme ekuilibri. Hapësira u projektua për të treguar bashkëjetesën e lojërave olimpike urbane mes mjedisit natyror, të simbolizuar nga Zona e Gjellbër Olimpike, vendi kryesor i lojërave të vitit 2008.

Stadiumi përfaqëson një bashkim të parimeve arkitekto- rore bashkëkohore dhe ndikimeve tradicionale kineze. Forma e tij dalluese eliptike dhe struktura e tij në formë rrjete të sjellin në mendje imazhin e një foleje zogu, një shenjë respekti si për natyrën ashtu edhe për trashëgiminë kulturore të kombit.

Kulla e Jetës, Senegal

Kulla e Jetës është një propozim projekti për një kullë ikonike në Dakar, Senegal. Është një ndërtim pozitiv ndaj energjisë i mbështjellë me një membranë toke të shtypur në vend. Struktura funksionon si një sistem i gjallë, duke mobi-



lizuar një ekonomi burimesh, energjie, uji, ajri, kulture dhe robotike. Kulla e Jetës është ikona arkitekto- rore e Epokës Ekologjike. Me energji pozitive dhe karbon negative, ky rrokaqiell që imiton baobabin është një shembull i arkitekturës biomimetike dhe integritetit me mjedisin.

Ndërtesa, një strukturë gji-

gante që synon të bëhet një pikë referimi e qytetit të Dakarit në Senegal, merr frymëzimin e saj nga baobab, një simbol i atij vendi afrikan. Ngjyra e saj prej terrakote evokon ndërtimet e

thjeshta prej balte të rajonit dhe tonalitetin e peizazheve të tij. Megjithatë, ajo gjithashtu vlerëson teknologjitë e së nesërme.

Kulla e Jetës: një ekosistem i vetëmjaftueshëm, e parashikuar nga një firmë arkitekto- rore libaneze, i plotëson disa nga kërkesat e mësipërme.

Në terma të energjisë, ajo mund të gjenerojë më shumë energji sesa konsumon. Së pari, kjo arrihet përmes efikasitetit të energjisë, pasi struktura e jashtme prej dheu ndihmon në gjenerimin e një mikroklimë përmes performimeve të saj. Së dyti, ajo përdor xham fotovoltai- k për të gjeneruar energji elektrike dhe një sistem mbledhjeje të ujit të shiut që shkon në një rezervuar në themele. Në bazën e ndërtesës ka edhe një bioreaktor që transformon mbetjet organike në energji.

Gjurma negative e karbonit arrihet përmes këtyre sistemeve të energjisë, por edhe

falë përdorimit të printimit 3D me lëndë të para me burim vendas, duke zvogëluar kështu nevojat e energjisë për transport dhe prodhim. Kështu, e gjithë struktura e jashtme është ndërtuar me tokë lokale dhe shtypje aditive.

Imitimi i formave organike

(Vijon në faqen 13)

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga faqja 14)

Biomimetika në Arkitekturë dhe Planifikimin Urban

reflektohet në të njëjtën strukturë të jashtme, e cila përdor




modele reagimi-difuzioni, një model matematik që përcakton shpërndarjen e njollave tek peshqit ose kafshët. Siç u theksua, këto hapje modulojnë dritën që arrijnë në brendësi të ndërtesës. Ato aplikohen gjithashtu në të gjithë vendin përreth, pasi është planifikuar një muze për bodrumin, i cili do t'i përdorë hapjet si dritare çatie.

Më konkretisht, Kulla e Jetës do të arrijë 290 metra lartësi dhe do të ketë vertiporte për dronë dhe helikopterë. Zona e sipërme do të strehojë gjithashtu një pyll për të rregulluar temperaturën dhe nivelet e oksigjenit. E gjithë kjo do të monitorohet nga një seri sensorësh, të cilët do të zbulojnë gjithçka, nga nivelet e lagështisë deri te cilësia e ajrit, temperatura dhe nivelet e banimit në secilën hapësirë.

Shtëpia e Këshillit të Qytetit CH2, Melbourne

Shtëpia e Këshillit 2, një ndërtesë administrative për Qytetin e Melburnit, është e para në vend që arrijnë vlerësimin më të lartë të mundshëm prej gjashtë yjesh në akreditimin mjedisor Green Star të Australisë. Sipërfaqja 12500 m².

Çdo aspekt i ndërtesës është shqyrtuar dhe rimenduar që nga parimet e para, duke zhvil-



luar parime të reja që bazohen në dëshirën për të qenë sa më besnikë ndaj "ligjeve themelore të natyrës". Kjo ka implikime për formën arkitekturore të ndërtesës dhe për të gjithë inxhinierinë shumë të sofistikuar brenda saj. Përbërja e kësaj ndërtese - lëkura e saj, kockat e saj, vetë brendësia e saj - i është nënshtruar një rivlerësimi rigoroz për ta përshtatur atë

me proceset natyrore. Kjo pranon realitetin se ne, si shoqëri, duhet të zhvillojmë struktura më të qëndrueshme për të jetuar dhe punuar, nëse duam të mbijetojmë si specie.

Fytyra publike e CH2 është fasada e lartë me pamje nga Rruga Swanston, një nga bulevardet publike të Melburnit. Është tërësisht i përbërë nga dërrasa vertikale prej druri që mbulojnë një mur të mbuluar plotësisht me xham. Këto dërrasa rrotullohen vertikalisht, duke u hapur dhe mbyllur në përgjigje të kohës së ditës dhe këndit të diellit. CH2 ftohet nga një menaxhim në kohë i ndryshimit të temperaturës midis ajrit të natës dhe ajrit të ditës. Në këtë rast, një anë e tërë e ndërtesës hapet për të marrë ajër direkt përmes grilave automatike të bëra nga druri i ricikluar.

Fasada është kështu e animuar në përgjigje të drejtpërdrejtë të kushteve të jashtme. Fasada, për shembull, pasqyron parimet që gjenden në kodrat e termitëve. Dizajni unik lehtëson ventilimin natyror, duke i lejuar ndërtesës të marrë frymë dhe të ruajë një temperaturë të rehatshme të brendshme. Kjo është biomimetika në formën e saj më të mirë - ndërtesa lëviz dhe bëhet e gjallë në përgjigje të kushteve përreth saj.

Kurora e ndërtesës strehon një element tjetër që shpall me vend filozofinë e dizajnit. Gjashtë turbina ere të mëdha, të verdha të ndritshme, janë një homazh vizual i përshtatshëm për mënyrën se si lëviz ajri rreth brendësisë së CH2, duke shpallur mënyrën se si kjo ndërtesë shfrytëzon një burim tjetër të fuqishëm natyror, erën.

CH2 gjithashtu përdor një gradient gjatë të temperaturës së një lëngu, ujin, për të kondicionuar ajrin në ndërtesë. Së pari, uji "nxirret" nga furnizimi me ujëra të zeza të qytetit, filtrohet trefish dhe më pas vihet në punë për të shkarkuar tualetet, ujitur bimët dhe për të kondicionuar ajrin. Uji i ajrit të kondicionuar rrjedh poshtë pjesës së jashtme të strukturës përmes pesë "kullave të dushit" 15 metra të cilat krijojnë ajër të ftohur në mënyrë avuluese për induksion në hapësirat e poshtme tregtare.

E projektuar nga Design-Inc në Melbourne, Australi, ndërtesa e zyrave e Shtëpisë së Këshillit 2 (CH2) u projektua të jetë një sistem holistik me banorët e saj si pjesëmarrës. CH2 përdor biomimetikën në përbërjen e saj arkitekturore. Natyra përdoret si frymëzim për fasadat që zbutin klimën, kanalet e ventilimit të ngushta integrohen me strategjitë e ndriçimit të ditës dhe një strukturë sugjестive e valëzuar e dyshemesë prej betoni luan një rol qendror në ngrohjen dhe ftohjen e ndërtesës.

Shtëpia e Këshillit të Melburnit 2 (CH2) është një

ndërtesë frymëzuese dhe fituese e shumë çmimeve që ka ulur emetimet e CO2 me 87%, konsumin e energjisë elektrike me 82%, gazin me 87% dhe ujin me 72%. Ndërtesa pastron ajrin e ndenjur natën dhe thith 100% ajër të pastër gjatë ditës. Pjesa e jashtme e ndërtesës lëviz me diellin për të reflektuar dhe mbledhur nxehtësinë, dhe i shndërron ujërat e zeza në ujë të përdorshëm. Ndërtesa ka përmirësuar efektivitetin e stafit me 4.9% dhe do të shlyejë vehten për karakteristikat e saj të qëndrueshme brenda pak më shumë se një dekadë.

Muzeu i Artit Milwaukee, Wisconsin

Muzeu i Artit Milwaukee është një muze i teknologjisë së fundit me pamje nga Liqeni Michigan në Wisconsin, SHBA. Muzeu i Artit Milwaukee është një projekt që ka zbehur kufijtë midis inxhinierisë



dhe arkitekturës. Ka elementë të shumtë të biomimikrisë në strukturë të frymëzuar nga vendndodhja e saj përballë liqenit: perde çeliku të lëvizshme të frymëzuara nga krahët e një zogu, një urë këmbësorësh me tela me një direk të ngritur të frymëzuar nga forma e një varke me vela dhe një galeri e lakuar e një kati të vetëm që i ngjan një vale.

Planifikimi i zhvillimit të qytetit sipas cilësive të Miksomiceteve


"Miksomiceti", i njohur gjithashtu si myku i llucës, është një organizëm njëqelizor që është i aftë të hartëzojë rrugë shumë komplekse dhe

të komunikojë informacion për të gjetur ushqimin e tij, të gjitha pa pasur tru, sistem nervor ose ndonjë nga organet që imagjinojmë kur mendojmë për këto detyra komplekse. Speciet si Physarum polycephalum janë përdorur për të simuluar rrjetet e trafikut. Myku i llucës ka ekzistuar për rreth një miliard vjet dhe ka evoluar gjatë asaj kohe për të qenë vërtet efikas dhe adaptues drejt qëllimit të tyre të vetëm të ushqyerjes dhe mbijetesës. Pra, kur një grup shkencëtarësh në Japoni vendosën ushqimin e tyre të preferuar, thekon e tërshërës, në vende të ndryshme që korrespondojnë me qytetet kryesore në Japoni, kjo krijesë ishte në gjendje që, brenda 5-6 ditëve, të hartëzonte rrjetin kompleks hekurudhor, të cilin inxhinierëve japonezë u deshën vite për ta planifikuar dhe hartëzuar. Kjo teknologji, e përsosur në natyrë, mund të ndihmojë vërtet në hartën e trafikut

në vendet e reja në zhvillim në Afrikë dhe Azi, si dhe në planifikimin e zhvillimit të qyteteve dhe banesave.

Rrjeti Physarum polycephalum i rritur në një periudhë prej 26 orësh (6 faza) për të simuluar rrjetin hekurudhor të Tokios së Madhe.

Atsushi Tero dhe kolegët e tij e rritën Physarum në një enë të lagësht të sheshtë, duke e vendosur mykun në një pozicion qendror që përfaqësonte Tokion, dhe thekon tërshërë që e rrethonin atë që korrespondonin me vendndodhjet e qyteteve të tjera të mëdha në Zonën e Madhe të Tokios. Meqënëse Physarum shmang dritën e ndritshme, drita u për-




Rrjeti Physarum polycephalum i rritur në një periudhë prej 26 orësh (6 faza) për të simuluar rrjetin hekurudhor të Tokios së Madhe.

dor për të simuluar malet, ujin dhe pengesat e tjera në enë. Myku fillimisht e mbushi dendur hapësirën me plazmodia, dhe më pas e holloi rrjetin për t'u përqëndruar në degët e lidhura në mënyrë efikase. Rrjeti i ngjante shumë sistemit hekurudhor të Tokios. Physarum polycephalum u përdor në përafritmet eksperimentale laboratorike të rrjeteve autostradale të 14 zonave gjeografike: Australi, Afrikë, Belgjikë, Brazil, Kanada, Kinë, Gjermani, Iberi, Itali, Malajzi, Meksikë, Holandë, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA. Struktura filamentare e Physarum polycephalum që formon një rrjet drejt burimeve ushqimore është e ngjashme me strukturën filamentare të galaktikës në shkallë të gjerë të universit. Ky vëzhgim i ka çuar astronomët të përdorin simulime të bazuara në sjelljen e myqeve të llucës për të informuar kërkimin e tyre për materien e errët.

Village of Lavasa, India, Shembulli Biomimikës (Bioimitimit) në Planifikimin Urban

Duke folur në një konferencë, Janine Benyus komentoi: "Si ia dalin pilivesat të manovrojnë më mirë se helikopterët tanë më të mirë? Si ia dalin



kolibrat të kalojnë Gjirin e Meksikës me më pak se një të dhjetën e 30 gram "karburant"? Si i mbajnë milingonat ekuivalentin e një barre të qindra paundëve në nxehtësi të plotë përmes një xhungle? Si ia dalin termitet të mbajnë temperaturë konstante prej 30° C në habitatin e tyre përmes nxehtësisë dhe të ftohtit? Përgjigjet e këtyre pyetjeve do të jenë zgjidhja për shumë nga problemet tona. Është koha të mësojmë për natyrën, jo me qëllim për të kontrolluar, por me qëllim për t'u përshtatur dhe për të zgjidhur jetën në tokë përgjithmonë."

Duke folur për përpjekjet e Lavasa-s për të krijuar një qytet ekologjikisht të qëndrueshëm, zonja Benyus tha: "Ne kemi nevojë për ide të reja dhe duhet të revolucionarizojmë mënyrën se si jetojmë, krijojmë dhe ekzistojmë. Lavasa është një përpjekje e shkëlqyer drejt krijimit të një banese njerëzore për të imituar idetë e natyrës. Ne kemi nevojë për shumë më tepër Lavasa në botë në mënyrë që të të

sigurohemi që të zgjasim më gjatë në planetin Tokë"

Janine dhe ekipi i saj, së bashku me HOK, e kanë sjellë këtë vizion në jetë. Sot, ne po punojmë me shpejtësi drejt ndërtimit të qytetit të parë model në botë bazuar në parimet e Biomimetikës në Mugaon në Lavasa. Qyteti i Lavasa-s, i cili zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 kilometrash katrorë do të ketë një ekonomi të vetëqëndrueshme dhe do të përfshijë të gjithë spektrin e klasave socio-ekonomike. Do të përfshijë mikpritjen, turizmin dhe kohën e lirë nga njëra anë dhe arsimin, kërkimin dhe bizneset inovative nga ana tjetër.

Lavasa është qyteti i parë kodrinor i lirë i Indisë që po zhvillohet nga HCC (Hindustan Construction Company) ku njerëzit mund të jetojnë, punojnë, mësojnë dhe argëtohen në harmoni me natyrën. Një qytet gjithëpërfshirës, i bazuar në parimet e Urbanizmit të Ri, po zhvillohet me shpejtësi mbi 18,000 hektarë tokë.

Qyteti kodrinor ofron dizajne arkitekturore bashkëkohore por të përditshme, mundësi të shumta për strehim si strehim me qira, shtëpi fillëtare, apartamente dhe vila. Me infrastrukturë dhe pajisje të teknologjisë së fundit, do t'u mundësojë njerëzve të jetojnë jetën plotësisht.

Biomimikja me famë botërore, Janine Benyus, dhe



ekipi i saj punuan në këtë projekt - i cili është ende në përfundim - për të krijuar një fshat miqësor ndaj jetës në Indi. Ata shikuan pyllin gjetherënës në zonë dhe replikuan gjashtë "shërbime ekosistemi" që mundën të identifikonin, në projektin e tyre urban. Kjo përfshin çati që lëshojnë ujë musoni si avull, trotuare të përshkueshëm nga uji për thithjen e ujërave nëntokësore dhe themele që ankorohehen si rrënjë pemësh. Rrugët janë modeluar sipas kodrave lokale të milingonave, struktura dredha-dredha e të cilave ndihmon në ngadalësimin dhe kanalizimin e reshjeve të dendura të shiut. Lavasa do të bëhet qyteti i parë në botë që vendos standarde duke përdorur Biomimetikën. Qyteti i Lavasa është i përkushtuar ndaj ruajtjes dhe përmirësimit të biodiversitetit mjedisor, duke krijuar një vend ku njeriu dhe natyra bashkëjetojnë në harmoni.

(Vijon në gazetën e ardhshme)



Agro Invest



Agrokredia

Norme efektive deri në: 3.5%

Financimi: Deri në 25.000.000 LEKË

Afati: Deri në 5 vite

Skano për
më shumë

